

VENDIM
Nr. 00–2018–611, datë 7.2.2018
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i përberë nga:

Artan Broci kryesues
Medi Bici anëtar
Shkëlzen Selimi anëtar

Në Dhomën e Këshillimit, të datës 7.2.2018, mori në shqyrtim çështjen civile që u përket palëve:
PADITËS/TË KUNDËRPADITUR:

1. Drita Kodra;
2. Fatime Muslli;
3. Ahmet Fejzoll;
4. Behije Xhindi;
5. Selami Fejzoll;
6. Hasan Fejzoll;
7. Qerime Goxhaj;
8. Petref Dilka;
9. Alfred Dilka;
10. Xhesila Dilka;
11. Myfit Muslli;
12. Afërdita Muslli;
13. Sara Muslli;
14. Xhoni Muslli;
15. Nuri Fejzoll;
16. Nadire Hoxhallari;
17. Rahmije Gjyli;
18. Aleks Foti;
19. Vajbe Fama;
20. Anesti (Hyqmet) Fejzoll;
21. Edlira Fejzoll;
22. Alketa Fejzoll.

TË PADITUR/KUNDËRPADITËS:

1. Agjencia e Trajtimit të Pronave;
2. Gjela Çipi;
3. Kristo Çipi.

OBJEKTI I PADISË: *Ndryshimin e vendimit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Korçë, nr. 1007, datë 18.6.2009, përkatësisht, duke ndryshuar pikën a. 2) 6 duke e kthyer fizikisht sipërfaqen e lirë prej 2450 m² (s1) dhe 357 m² (s2) referuar planit të riveimit me topograf të marrë nga palët referuar.*

BAZA LIGJORE: *Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, me ndryshimet përkatëse, nenet 153, 154 të K.Pr.Civile, si dhe vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Gjykatës së Lartë.*

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: *Detyrim për njohje pronar.*

BAZA LIGJORE: *Nenet 153,154 të K.Pr.Civile dhe 168, 169 dhe 296 të K.Civil.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. s’ka, datë 25.5.2017, ka vendosur:

- Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e padisë në çështjen civile me nr.regj 21291–00440–41–2017 (594) dt.regj 9.2.2017, e palë paditës Drita Kodra, Fatime Muslli, Ahmet Fejzoll etj..., të paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, Gjela Çipi dhe Kristo Çipi, me pjesëmarrjen

e Avokaturës së Shtetit, Zyrës Vendore Korçë, me objekt: ndryshimin e vendimit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Korçë, nr. 1007, datë 1.6.2009, përkatësisht, duke ndryshuar pikën a. 2)6 duke e kthyer fizikisht sipërfaqen e lirë prej 2450 m² (s1) dhe 357 m² (s2) referuar planit të nivelimit me topograf të marrë nga palët referuar.

- Veçimin e kundërpadisë dhe dërgimin e padisë së bashku me aktet bashkëngjitur saj në Gjykatën e Apelit Korçë si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes.

- Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Për palën e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.”.

Gjykata e Apelit Korçë, në datën 15.11.2017, ka parashtruar qëndrimin për rregullimin e kompetencës, duke kërkuar: *“Marrihen parasysh të qëndrimit të sipërcituar për rregullimin e kompetencës lëndore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes civile, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”* dhe ka parashtruar këto arsye:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 29, të ligjit nr. 133/2015 për sa i përket përcaktimit të kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Neni 29, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, përcakton shprehimisht se: “Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”;

- Nga interpretimi gramatikor i kësaj dispozite, si dhe nga interpretimi sistematik i saj me nenet 20, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji rezulton se Gjykata e Apelit ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, të dhëna në bazë dhe në zbatim të ligjit të ri nr. 133/2015, dhe jo për shqyrtimin e çështjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të dhëna nga ish-Agjencia e Kthimit apo Kompensimit të Pronave apo ish-komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave mbi bazën e ligjit të mëparshëm nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”;

- Në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 133/2015, nuk rezulton të ketë ndonjë parashikim për fuqinë prapavepruese të këtij ligji në lidhje me gjykimin e çështjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të ish-Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave të dhëna në bazë të ligjeve të mëparshme që kanë qenë në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015. Fuqia prapavepruese e ligjit ka vend për t’u zbatuar në rastin e dispozitave materiale, ndërkohë që ligji nr. 133/2015, ka në përmbajtje të tij dispozita të përziera të karakterit material dhe atij procedural;

- Ky qëndrim, në lidhje me karakterin e përzierë të ligjeve të mëparshme për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe për fuqinë prapavepruese të këtij ligji, është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 7, datë 24.3.2005, në të cilin, ndër të tjera, rezulton të jenë dhënë edhe këto konkluzione unifikuese: “Kolegjet e Bashkuara pranojnë se “fuqia prapavepruese e ligjit është lidhur kryesisht me ligjin material dhe ajo nuk është në natyrën e ligjit procedural. Është vetë ligji procedural ai që duhet të përcaktojë se si duhet vepruar me rastin e hyrjes në fuqi të tij. Nisur nga fakti që nuk ka një dispozitë kalimtare në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, i cili në vetvete është një ligj që përmban dispozita materiale dhe procedurale, si dhe fakti që marrëdhëniet juridike dhe mosmarrëveshjet për to kanë lindur para hyrjes në fuqi të tij, ligji i aplikueshëm duhet të jetë ligji i kohës;

- Një interpretim i ndryshëm i nenit 29, të ligjit nr. 133/2015, si në rastin konkret, do të ishte me pasojë të rënda për palët në këto gjykime, pasi siç përcaktohet në vendimin unifikues nr. 7, datë 24.3.2005, ato nuk mund të detyroheshin të kryenin të tjera procedura;

- Nga përmbajtja e akteve të dosjes gjyqësore rezulton se kërkesëpadia e paditësve Drita Kodra etj.,

është paraqitur në gjykatë në datën 9.2.2017 dhe ka për objekt të kontestimit, vendime të ish-AKKP (vendime të drejtorit të përgjithshëm), nëpërmjet të cilave është cenuar përmbajtja e vendimit nr. 1007, datë 18.6.2009, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave qarku Korçë;

- Kjo situatë juridike nuk mund të zgjidhet duke referuar në përcaktimet e nenit 29, të ligjit nr. 133/2015, që rregullon situatën kur ka një vendim nga ATP-ja, i cili mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën e Apelit. Ç'kuptim do të kishte ky afat 30-ditor në rastin konkret, kur kemi të bëjmë me një vendim të marra ish-ZRKKP apo AKKP? Kjo dispozitë rregullon situatën juridike kur sipas ligjit të ri (nr. 133/2015) është shprehur ATP-ja dhe subjektet e interesuara brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi mund t'i drejtohen Gjykatës së Apelit për rastet që janë parashikuar shprehimisht në këtë ligj. Dispozitat materiale të ligjit nr. 133/2015, nuk parashikojnë asgjë konkrete lidhur me mënyrën e trajtimit të një konflikti midis palëve që rrjedh nga vlerësimi nëse një pronë do të konsiderohet e lirë apo e zënë në kuptim të ligjeve të mëparshme, siç janë ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 dhe ligji nr. 9235/2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", që kanë trajtuar të drejtën e pronësisë dhe kanë disponuar për kthimin si të lirë të pronës apo të drejtën e kompensimit. Neni 29, i ligjit nr. 133/2015, flet në mënyrë të qartë për vendime të marra nga ATP-ja dhe jo vendime të marra nga ish-KKKKP-të, ZRKKP-të, apo AKKP-të. Për këto vendimmarrje tashmë ka një praktikë të konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si për natyrën e këtyre lloj gjykimesh, ashtu dhe për mënyrën e kontestimit të tyre;

- Nëse ligjvënësi do të kishte pasur për qëllim që sipas kësaj dispozite do të kundërshtoheshin në gjykatat e apelit edhe vendimet e marra sipas ligjeve të mëparshme nga ana e KKKKP-ve, ZRKKP-ve apo AKKP-ve, do ta kishte zgjidhur këtë situatë juridike nëpërmjet dispozitave kalimtare apo duke zgjeruar rrethin e vendimeve që kontestohen brenda vetë dispozitës, pra brenda parashikimeve të nenit 29, të ligjit nr. 133/2015.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Shkëlzen Selimi dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat

1. Paditësit, me padinë e depozituar në datën 9.2.2017, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Korçë, nr. 1007, datë 18.6.2009 përkatësisht, duke ndryshuar pikën a. 2) 6 duke e kthyer fizikisht sipërfaqen e lirë prej 2450 m² (s1) dhe 357 m² (s2) referuar planit të rivlimit me topograf të marrë nga palët referuar, bazuar në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", me ndryshimet përkatëse, nenet 153, 154, të K.Pr.Civile, si dhe vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

1.1 Më konkretisht, duke pretenduar se vendimi i Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të pronave është i paligjshëm, sipas paditësve, sipërfaqja prej 2450 m² dhe 357 m² duhej t'u kthehej fizikisht e lirë, trashëgimtarëve të ish-pronarit, të ndjerit z. Ali Fejzulli. Kjo pasi sipas tyre, nga ana e Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, Qarku Korçë nuk është bërë vendosja e saktë hartografike në terren sipas dokumentacionit të vjetër të origjinës së pronës. Si rrjedhojë paditësit kanë pretenduar se, të paditurit, z. Kristo Çipi dhe z. Gjela Çipi e posedojnë aktualisht në mënyrë të paligjshme këtë sipërfaqe, duke poseduar më shumë nga sa iu është shitur nga objekti peshore prej 31.2 m² e regjistruar me vol. 10 f. 117/ZK 1101. Sa më sipër, paditësit kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, qarku Korçë dhe kthimin si të lirë të sipërfaqes objekt mosmarrëveshjeje. Pretendimet e tyre ia kanë kundërtuar palëve të paditura, konkretisht Agjencisë së Trajtimit të Pronës, z. Kristo Çipi dhe z. Gjela Çipi.

1.2 Nga ana tjetër, pala e paditur ka paraqitur kundërpadi me objekt njohje pronar në lidhje me pasurinë objekt mosmarrëveshjeje.

II. Procedura gjyqësore

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. s'ka, datë 25.5.2017, ka vendosur:

“Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e padisë në çështjen civile me nr.regj 21291-00440-41-2017 (594) dt.regj 9.2.2017, e palë paditës Drita Kodra, Fatime Muslli, Ahmet Fejzollu, etj..., të paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, Gjela Cipi dhe Kristo Cipi, me pjesëmarrjen e Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë, me objekt: ndryshimin e vendimit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Korçë nr. 1007, datë 1.6.2009 përkatësisht duke ndryshuar pikën a. 2)6 duke e kthyer fizikisht sipërfaqen e lirë prej 2450 m² (s1) dhe 357 m² (s2) referuar planit të riveimit me topograf të marrë nga palët referuar.

- Veçimin e kundërpadisë dhe dërgimin e padisë së bashku me aktet bashkëngjitur saj në Gjykatën e Apelit Korçë si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes.

Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Për palën e paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.”

3. Gjykata e Apelit Korçë, më datë 15.11.2017 ka parashtruar qëndrimin për rregullimin e kompetencës; duke kërkuar: Marrjen parasysh të qëndrimit të sipërcituar për rregullimin e kompetencës lëndore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes civile, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë; dhe parashtron këto si arsye, ato të pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

III. Arsyetimi ligjor i vendimit të ankimuar

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e ka deklaruar veten moskompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e padisë dhe ndër të tjera arsyeton se:

“...Nga aktet e paraqitura nga palët në gjykim gjykata çmon se kërkesa e Avokaturës së Shtetit për shpalljen e moskompetencës lëndore të kësaj gjykate për shqyrtimin e kërkesë padisë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë është e mbështetur në ligj, për këtë arsye në mbështetje të nenit 61 të K.Pr.Civile kjo gjykatë duhet të vendosë moskompetencën e saj dhe të dërgojë aktet në Gjykatën e Apelit Korçë si gjykatë kompetente, nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështje. Në këtë konkluzion gjykata arrin duke iu referuar nenit 29 të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” ku është parashikuar se “Kundër vendimit të ATP- së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”. Kjo dispozitë nuk ka parashikuar zgjidhjen e çështjeve që janë në gjykim apo që paraqiten për gjykim në lidhje me vendimet e marra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pasi me nenin 38 të ligjit, me titull “Shfuqizime” është shfuqizuar ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar, mbi bazën e dispozitave të së cilit do të zgjidhej konflikti në gjykim. Për rrjedhojë duke qenë se ligji në fuqi ka parashikuar kompetencën e Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e padive me objekt kundërshtimin e vendimeve të ATP-së dhe ka shfuqizuar ligjin dhe interpretimet që i janë bërë atij nga Gjykata Lartë mbi bazën e së cilës do të zgjidhej ky konflikt më parë, gjykata konkludon se nuk është në kompetencën e saj lëndore gjykimi i kësaj mosmarrëveshje. Në mbështetje të nenit 41 të K.Pr.Civile ku parashikohet se “Në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrë-veshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”, kompetenca lëndore e gjykatës mund të caktohet edhe me ligj të posaçëm dhe në rastin konkret me ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” ka përcaktuar Gjykatën e Apelit si gjykatë kompetente për shqyrtimin e këtyre padive...”.

IV. Ligji i zbatueshëm

5. Neni 16/1 i K.Pr.Civile që parashikon se:

“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj...”.

6. Neni 61 i K.Pr.Civile parashikon se:

“Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.”

7. Neni 62 i K.Pr.Civile parashikon se:

“Kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, si dhe kundër vendimit të saj mbështetur në nenin 60 të këtij Kodi, mund të bëhet ankim i veçantë nga palët dhe nga prokurori, kur ka ngritur padi ose ka marrë pjesë në gjykimin e mosmarrëveshjes, në Gjykatën e Lartë”.

8. Në nenin 19, i ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” është parashikuar se:

“Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit”

9. Në nenin 29, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” është parashikuar se:

Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

10. Neni 38, i ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, në të cilin është parashikuar se:

“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar; ligji nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, dhe çdo dispozitë tjetër nënligjore, që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.”

V. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të gjykimit, arsyetimit të gjykatave në lidhje me çështjen konkrete, analizës së kuadrit ligjor, praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë, të gjykatave të apelit dhe praktikës së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështje të ngjashme arrin në konkluzionin se vendimi nr. s’ka, datë 25.5.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës së Apelit Korçë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të normave procedurale dhe për këtë shkak duhet të priset dhe aktet të dërgohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për vazhdimin e gjykimit. Njëkohësisht Kolegji vlerëson se vendimi për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi duhet të shërbejë për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me disa çështje, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e problematikës konkrete objekt gjykimi dhe problematikave të tjera të lidhura apo të rrjedhura prej saj.

12. Kolegji vlerëson se me datë **23.6.2016** ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”¹ (në vijim ligji nr. 133/2015). Ky ligj pati si qëllim përfundimin efektivisht të procesit të trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes dhe kompensimit të saj brenda një afati të arsyeshëm². Për këto arsye me këtë ligj u krijua një organ i vetëm, person juridik publik, vendimmarrës, konkretisht Agjencia e Trajtimit të Pronave (në vijim ATP), së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës dhe do të trajtojë përfundimisht kërkesat e ish-pronarëve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës.

13. Me qëllim përfundimin brenda një afati të arsyeshëm të procesit të kthimit të pronave, në nenin 29 të këtij ligji, është parashikuar se ankimet kundër vendimeve të ATP-së do të bëhen pranë gjykatave të apelit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ATP-së. Ndërkohë neni 19 i ligjit ka parashikuar se kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës mund të bëhet padi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit.

¹ Në nenin 39, të ligjit nr. 133/2015, është parashikuar se: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.” Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare, në datën 8.2.2016. Si rrjedhojë, ka hyrë në fuqi në datën 23.2.2016.

² Shiko vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

14. Në dispozitën tranzitore të ligjit nr. 133/2015, konkretisht në nenin 38 të tij, janë shfuqizuar ligjet e mëparshme, konkretisht, ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, ligji nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, dhe çdo dispozitë tjetër nënligjore, që është në kundërshtim me të. Nga ana tjetër, duke shfuqizuar bazën ligjore të veprimtarisë së gjykatave të shkallës së parë, në shqyrtimin e këtyre çështjeve, nuk ka një dispozitë tranzitore ku të parashikohet se çfarë do të ndodhë me çështjet të cilat janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, para gjykatave të shkallës së parë. Po ashtu, nuk ka një dispozitë tranzitore ku të rregullohet se cila gjykatë është kompetente për shqyrtimin e padive kundër vendimeve, që nuk janë marrë nga ATP-ja sipas ligjit nr. 133/2015, por janë marrë nga organet e mëparshme kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës, sipas ligjeve të shfuqizuara tashmë.

15. Nisur nga këto mangësi të ligjit nr. 133/2015, në praktikën e gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit dhe vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjet e evidentuara më sipër. Më konkretisht, në praktikën gjyqësore janë shtruar për diskutim dhe janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjet se në kompetencë së cilës gjykatë, do të jetë:

a) Shqyrtimi i çështjeve gjyqësore të regjistruara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015;

b) Shqyrtimi i padive kundër vendimeve të mëparshme të organeve administrative kompetente të kthimit dhe kompensimit të pronës, konkretisht ish-Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (në vijim ish-KKKP-të), ish-Zyrave Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim ish-ZRVKKP-të) apo ish-Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (ish-AKKP), të cilat paraqiten pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015;

c) Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve midis ish-pronarëve dhe të tretit, ku vendimi i organit kompetent për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk kundërshtohet më si akt administrativ, por si titull pronësie.

16. Si përfundim, ligji nr. 133/2015 ka parashikuar se kundër vendimeve të ATP-së, subjektet ish-pronare, mund t’i drejtohen gjykatave të apelit brenda afatit 30-ditor, nga komunikimi i vendimit. Nga ana tjetër, në nenin 26, të ligjit nr. 133/2015, ka parashikuar llojet e vendimeve që mund të marrë ATP-ja. Sipas kësaj norme vendimet që ATP-ja mundet të marrë janë: a) rrëzimi i kërkesës ose njohja sipas rastit e së drejtës së pronësisë; b) dhe kompensimi fizik, brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimi nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Nisur nga ky parashikim i ligjit, gjykatat kanë qenë të paqarta se në kompetencë së cilës gjykatë do të jetë kundërshtimi i vendimit që merr ATP-ja tej formave të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr. 133/2015, më konkretisht në kompetencë së cilës gjykatë do të jetë shqyrtimi i vendimeve të ATP-së kur merret vendim për mbylljen e procedimit pa u shprehur për themelin e kërtimeve.

17. Sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet këtij vendimi, duke ia besuar arsyetimin e këtij vendimi Kryetarit të Kolegjit Civil, ka vendosur të shtrojë këto çështje për të njëzuar praktikën gjyqësore:

i) Cila është gjykata kompetente, për paditë e regjistruara në gjykatë pas datës 23.2.2016, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015 dhe të paraqitura nga subjekti ish-pronar apo trashëgimtarët e tij, kundër vendimit të dhënë nga ish-KKKP-të, ish-ZRAKKP-të apo ish-AKKP-të, që ka disponuar në lidhje me kërkesën e tij, në bazë të ligjeve të mëparshme për kthimin dhe kompensimin e pronës?

ii) Cila është gjykata kompetente, për shqyrtimin e padisë, të kundërpadisë apo të padisë së ndërhyrësit kryesor, me të cilat, kundërshtohet vendimi i ish-KKKP-të, ish-ZRAKKP-të apo ish-AKKP-të dhënë në favor të një subjekti, nga i treti që e pretendon tërësisht apo pjesërisht për vete dhe në cilën gjykatë kundërshtohet ky vendim si titull pronësie?

iii) Cila është gjykata kompetente, për shqyrtimin e padive kundër vendimeve të ATP-së, kur

kjo e fundit jep vendim për mbylljen e procedimit pa u shprehur për themelin e kërtimeve: Gjykata e Apelit Civil, Gjykata Administrative e Apelit apo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë?

iv) Cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të organeve kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës, sipas ligjeve të mëparshme të shfuqizuara, për kthimin dhe kompensimin e pronës, e cila është regjistruar në gjykatë përpara datës 23.2.2016, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”?

A. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

Cila është gjykata kompetente, për paditë e regjistruara në gjykatë pas datës 23.2.2016, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015 dhe të paraqitura nga subjekti ish-pronar apo trashëgimtarët e tij, kundër vendimit të dhënë nga ish-KKKP-të, ish-ZRAKKP-të apo ish-AKKP-të, që ka disponuar në lidhje me kërkesën e tij, në bazë të ligjeve të mëparshme për kthimin dhe kompensimin e pronës?

18. Kolegji konstaton se neni 38, i ligjit nr. 133/2015, ka parashikuar se:

“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar; ligji nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, dhe çdo dispozitë tjetër nënligjore, që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.”.

Nga ana tjetër, neni 19, ka parashikuar se:

“1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga data e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit...”.

Ndërsa neni 29, i ligjit, ka parashikuar se:

“Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.”

Po ashtu neni 15, i ligjit nr. 133/2015, ka parashikuar se:

“1. Brenda një afati 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe sipas përcaktimeve të tij, ATP-ja vlerëson financiarisht të gjitha vendimet përfundimtare të pavlerësuara që kanë njohur të drejtën e kompensimit. 2. Nëse ATP-ja nuk përmbush brenda këtij afati 3-vjeçar detyrimin, sipas pikës 1, të këtij neni, subjektit i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë për të kërkuar vlerësimin financiar, sipas përcaktimeve të këtij ligji...”.

Në ligj nuk ka një dispozitë ku të parashikohet se ku do të mund të kundërshtohen vendimet e ish-AKKP-së, të ish-KKKP-ve apo të ish-ZRVKKP-ve, të cilat janë marrë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, sipas ligjeve të mëparshme të shfuqizuara dhe të cilat nuk janë objekt vlerësimi financiar nga ATP-ja.

19. Për të konkluduar mbi këtë çështje të shtruar për njësim, Kolegji çmon të marrë në analizë fillimisht arsyen dhe *ration* se pse lindi e nevojshme nxjerrja e një ligji të tillë, si dhe sfondin historik të tij. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disiplinojnë veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se identifikimi i ligjit të zbatueshëm për çështjen e kompetencës dhe juridiksionit për shqyrtimin e vendimeve të mëparshme të organeve pararendëse të ATP-së, të suprimuara tashmë, nuk mund të bëhet pa identifikuar njëkohësisht dhe paraprakisht edhe ligjin e zbatueshëm material për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në fjalë.

20. Ligji nr. 133/2015 pati si qëllim përfundimin efektivisht të procesit të trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes dhe kompensimit të saj brenda një afati të arsyeshëm.³ Referuar raportit shpjegues të projektligjit⁴, ishte e domosdoshme marrja e masave shtetërore, legjislative dhe administrative për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare procesit të kompensimit të pronës. Ky ligj pati si udhërrëfyes dhe doli në zbatim të vendimit pilot “*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*”, ku Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), vendosi detyrime të përgjithshme për shtetin shqiptar, për marrjen e masave konkrete për zbatimin e vendimeve të cilat kishin njohur të drejtën e kompensimit të ish-pronarëve, por nuk ishin ekzekutuar ende. GJEDNJ-ja mori një vendim pilot për shkak të kërkesave të shumta të së njëjtës natyrë para kësaj gjykate kundër shtetit shqiptar.

20.1 Ndër problemet që u vunë në dukje nga GJEDNJ-ja në këtë vendim, të cilat ishin konstatuar edhe në çështje të tjera të ngjashme (shiko çështjen *Ramadhi kundër Shqipërisë*, *Beshiri etj. kundër Shqipërisë*, *Hamzuraj kundër Shqipërisë*, *Nuri kundër Shqipërisë*, *Drizja kundër Shqipërisë* etj.), ishte ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës (të paktën shtatë herë midis periudhës 2004–2010); fakti se asnjë prej këtyre ligjeve apo ndonjë dispozitë tjetër e brendshme nuk parashikonte mënyrën se si do të zbatoheshin vendimet e organeve administrative të kthimit dhe kompensimit të pronës; fakti se nuk parashikohej afat për ankimin e këtyre vendimeve para gjykatave të brendshme ose ndonjë mjet specifik për zbatimin e tyre; si dhe fakti se këto ligje ia linin përsëri Këshillit të Ministrave, pra pushtetit ekzekutiv, të drejtën për të përcaktuar formën dhe mënyrën konkrete të kompensimit, duke përcaktuar rregullat dhe metodat e hollësishme përkatëse. Aktiviteti i mëparshëm i organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës, në të shumtën e rasteve, nuk kishte si objekt të veprimtarisë vlerësimin e pronës, por synonte vetëm njohjen e statusit të ish-pronarit, njohjen e të drejtave të pronësisë të ish-pronarit kthimin apo kompensimin e pronës⁵, duke disponuar në mënyrë të papërcaktuar dhe duke mosindividualizuar detyrimin apo të drejtën konkrete, por të përcaktueshme më tej nga pushteti ekzekutiv, mbi kompensimin e pronës. Kështu, pritshmëritë e ligjshme të ish-pronarëve përcaktoheshin nga vendime të cilat në shumicën e rasteve njihnin të drejtat mbi sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme, por nuk përcaktonin vlerën financiare të kompensimit. Me ligjet e mëparshme nuk ishte parashikuar një skemë konkrete dhe përfundimtare, por një skemë tranzitore kompensimi. Skema tranzitore e kompensimit sipas vlerave të tregut të kohës së kompensimit u konsiderua nga GJEDNJ-ja si mjet joefektiv për ekzekutimin e vendimeve që njihnin të drejtën e kompensimit.

20.2 Ndër të tjera, GJEDNJ-ja në këtë vendim pilot ka theksuar se ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës dhe mospasja e një skeme të qartë dhe konkrete për vendimet e kompensimit ka krijuar pasiguri tek ish-pronarët dhe ka cenuar të drejtat e tyre për gëzim paqësor të pasurisë sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNJ). Po ashtu, mosekzekutimi për një kohë të gjatë i vendimeve të formës së prerë në favor të ish-pronarëve, që iu është njohur e drejta e kompensimit, ka cenuar të drejtat e tyre për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së.

20.3 Në vijim të këtij arsyetimi, GJEDNJ-ja caktoi detyra për marrjen e masave me karakter të përgjithshëm për shtetin shqiptar, duke pezulluar shqyrtimin e ankimeve për çështje të ngjashme që do të paraqiteshin para GJEDNJ-së dhe duke ngritur shqetësimin se po minohej seriozisht sistemi i të drejtave të njeriut të parashikuar nga KEDNJ-ja, për të cilin shteti shqiptar ishte zotuar ndërkombëtarisht ta respektonte, për shkak të shkeljeve sistematike të përsëritura në raste të ngjashme. Ndër të tjera, GJEDNJ-ja vuri theksin te marrja e masave të përgjithshme prioritare ligjore dhe

³ Shiko vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁴ https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/relacioni_trajtimi_i_pronave_24184_1.pdf

⁵ Shiko [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2016\)049-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2016)049-e)

nënligjore me qëllim sigurimin në mënyrë efektive të së drejtës për kompensim, duke vendosur një balancë të drejtë midis interesit publik dhe interesit privat të ish-pronarit. Po ashtu, GJEDNJ-ja theksoi se duhet të shmanget ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit përkatës i cili shkakton një mungesë të përgjithshme të sigurisë juridike; duhet të merret dhe të përpunohet një informacion i saktë për numrin e përgjithshëm të vendimeve administrative që njihnin të drejtat e pronësisë dhe dhënien e kompensimit në mënyrë të papërcaktuar, të cilat sipas rastit ishin miratuar që prej vitit 1993. Kjo që do të mundësonte llogaritjen e një faturë të përgjithshme të kompensimit, e cila do të duhej të shoqërohej, nga një skemë e qartë kompensimi e hartuar me kujdes, duke shmangur procedurat e ngarkuara burokratike dhe administrative. Si përfundim, GJEDNJ-ja theksoi se këto përfundime do të kërkonin qartë një rishqyrtim të modaliteteve për pagesën e kompensimit financiar që zbatohej aktualisht. Rishikimi dhe përditësimi i hartave të vlerës do të duhej t'i nënshtrohej kritereve transparente dhe shpjeguese, duke marrë parasysh zhvillimet e tokës dhe luhatjet e tregut të saj.

21. Në zbatim të këtyre detyrimeve, si dhe neneve 41 dhe 181, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, u hartua ligji nr. 133/2015, për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës, ku u vendos një mekanizëm konkret kompensimi për ish-pronarët (shiko nenet 6–14 të ligjit). U krijua një organ i vetëm, i centralizuar, person juridik publik, konkretisht ATP, në varësi të ministrit të Drejtësisë, e cila do të trajtonte kërkesat e ish-pronarëve për kompensim dhe së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e ish-AKKP-së. Po ashtu, i gjithë procesi i trajtimit të ish-pronarëve u disiplinua nga afate të përcaktuara. Konkretisht u vendos një afat i përgjithshëm për përfundimin e procesit të kompensimit financiar të ish-pronarëve, 10-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit (neni 16/6); u vendos një afat disiplinues për veprimtarinë e ATP-së, trevjeçar, për trajtimin e çdo kërkesë të ish-pronarit për vlerësimin financiar të vendimeve të mëparshme të pavlerësuar që kanë njohur të drejtën e kompensimit (neni 15); u caktua një afat prekluziv⁶ për aplikim, për kërkesat e paraqitura rishtazi nga ish-pronarët, konkretisht afati prej 90 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit (neni 27), si dhe u vendosën afatet 30-ditore për kundërshtimin e vendimeve të ATP-së në gjykatë (nenet 19 dhe 29 të ligjit). Po ashtu, u përcaktua me ligj metodologjia dhe kriteret e kompensimit të pronës, duke marrë për bazën vlerën e pronës sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit (shiko nenet 6 dhe 7 të ligjit). Me qëllim përfundimin e shpejtë të procesit të trajtimit të pronës, ligji ka përcaktuar si gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis ish-pronarit dhe shtetit të përfaqësuar nga ATP-ja, gjykatat e apelit (civil dhe administrativ) të cilave iu ka atribuar juridiksion fillestar, duke shmangur një shkallë të shqyrtimit gjyqësor të këtyre çështjeve.

22. Në nenin 3, të ligjit nr. 133/2015, u përcaktua fusha e veprimit të tij, ku përfshiheshin të gjitha vendimet të cilat kishin njohur të drejtën e kompensimit nga organet administrative dhe gjyqësore, por që nuk ishin ekzekutuar, për të gjitha kërkesat në shqyrtim në AKKP në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit dhe për të gjitha çështjet në gjykim, për sa i përket vlerësimit financiar. Me këtë ligj nuk u njoh më e drejta e kthimit fizik të pronës, por vetëm e drejta e kompensimit. Format e kompensimit sipas këtij ligji janë: *kompensimi financiar*, *kompensimi fizik* nga fondi i tokës, *kompensimi fizik brenda pronës së njohur* të subjektit të shpronësuar, kompensimi me aksione në shoqëritë me kapital shtetëror, si dhe *kompensimi me vlerën e objekteve* të cilat janë objekt i privatizimit (neni 8).

23. Për efekt të çdo lloj kompensimi si më lart, sipas ligjit nr. 133/2015, do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe vlerësimit financiar nga ATP-ja të gjitha vendimet e përfundimtare, të formës së prerë (administrative ose gjyqësore), që kanë njohur të drejtën e kompensimit, por që ende nuk janë ekzekutuar (shiko nenet 2, 3 dhe 5 të ligjit)⁷.

⁶ I cili nuk mund të zgjatet dhe as nuk mund të rivendoset nga gjykata apo ndonjë organ tjetër administrativ (neni 27 i ligjit nr. 133/2015).

⁷ Neni 2 i ligjit nr. 133/2015 ka parashikuar se: “*Qëllimi i këtij ligji është: ...b) rregullimi dhe shpërbëimi i drejtë i kompensimit të pronës, ekzekutimi i vendimeve përfundimtare të kompensimit, si dhe përfundimi i procesit të kompensimit brenda afateve të*

24. Më tej, në nenin 6 të ligjit u konkretizua metodologjia se si do të bëhej vlerësimi financiar i pronës nga ATP-ja për efekt të kompensimit. Sipas kësaj dispozite do t'i nënshtrohen rivlerësimit nga ATP-ja të gjitha vendimet e formës së prerë, të paekzekutuara, të ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, ish-zyrave rajonale vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe të ish-AKKP-ja, që kanë njohur:

- 1) *Vetëm të drejtën e kompensimit (pa përcaktuar vlerë apo sipërfaqe);*
- 2) *Vetëm të drejtën e kompensimit të përcaktuar në sipërfaqe;*
- 3) *Të drejtën e kthimit pjesërisht dhe kompensimit (të papërcaktuar në vlerë apo sipërfaqe);*
- 4) *Të drejtën e kthimit pjesërisht dhe kompensimit (në sipërfaqe).*

Sipas kësaj dispozite vendimet përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit, financohen sipas zërit kadastral, që ka pasur prona e kthyer apo e kompensuar në kohën e shpronësimit. Ndërsa vendimet e kompensimit të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara, nga periudha e njohjes të së drejtës për kompensim deri në marrjen e shpërbllimit, do të përfitojnë indeksimin, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesit bankar (pika 7 e nenit 6).

25. Nisur nga ky parashikim i ligjit, u duk sikur tej asaj që vendoste si detyrim GJEDNJ-ja, për përcaktimin e një mekanizmi përfundimtar për ekzekutimin e vendimeve që njihnin të drejtën e kompensimit (në mënyrë të papërcaktuar), ligji nr. 133/2015 i shtriu efektet te të gjitha vendimet e formës së prerë që njihnin të drejtën e kompensimit, duke iu nënshtuar rishikimit dhe rivlerësimit edhe pronat e kthyer apo të kompensuara më parë.

25.1 Ligji nr. 133/2015 iu nënshtua kontrollit nga Gjykata Kushtetuese, e cila gjatë gjykimit iu drejtua për marrjen një opinioni të specializuar, organit këshillimor ndërkombëtar (*amicus curia*), të Këshillit të Evropës, konkretisht Komisionit të Venecias. Subjektet që iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese kërkuan shfuqizimin e ligjit nr. 133/2015 në tërësi si antikushtetues, për disa arsye. Në mënyrë të përmblodhur ato pretenduan se skema e ofruar për zgjidhjen e problemit sistematik në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të kompensimit të pronarëve, që kanë një vendim përfundimtar administrative, nuk garanton efektivitet për zgjidhjen e problemit dhe as parashikueshmëri, për shkak të afatit trevjeçar të parashikuar në nenin 15 të ligjit. Ato pretenduan se cenohet siguria juridike për shkak të rishikimit të vendimeve të formës së prerë, që kanë kthyer apo kompensuar pronën, të cilat do të vlerësohen tashmë sipas vlerës së pronës në kohën e shpronësimit. Ato pretenduan se ligji trajton në mënyrë të pabarabartë ish-pronarët, kërkesat e të cilëve janë në shqyrtim në AKKP në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit apo të atyre që paraqesin kërkesat pas hyrjes në fuqi të ligjit, për sa kohë nuk njihet më e drejta e kthimit të pronës, ndryshe nga sa parashikonte ligji i mëparshëm, i cili njihte të drejtën e kthimit dhe kompensimit sipas vlerës në kohën e shpronësimit. Ato pretenduan se ligji krijon pasiguri juridike tek ish-pronarët, të cilët do të duhet të presin që më parë të bëhet vlerësimi për tokën, referuar llojit të pronës në momentin e shpronësimit. Ato pretenduan se ligji cenon të drejtën e ankimit, sepse ish-pronari mund të apelojë vendimin vetëm në një gjykatë ligji sikurse është Gjykata e Lartë dhe se ligji cenon të drejtën e pronës sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nuk parashikon një shpërbllim të drejtë sipas orientimeve të GJEDNJ-së në jurisprudencën e saj në shumë çështje simotra.

26. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 shfuqizoi nenin 6, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr.

përcaktuara në këtë ligj, nëpërmjet fondit të kompensimit.” Po ashtu, neni 3/2 i ligjit nr. 133/2015 ka parashikuar se: “...Gjithashtu ky ligj i shtrinë efektet sa i takon vlerësimit financiar, për: a) ekzekutimin e të gjitha vendimeve, të cilat nuk janë zbatuar, për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore në vendin tonë; b) çështjet që janë në shqyrtim në gjykatat e të gjitha niveleve, në Gjykatën e Lartë, si edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa i takon vlerësimit financiar të tyre.” Neni 5/16 ka parashikuar se: “...Vlerësim është vlerësimi financiar që ATP-ja i bën vendimit përfundimtar të kompensimit sipas dispozitave të këtij ligji...” Po ashtu, në pikën 18 të kësaj dispozite është parashikuar se: “Vendim për kthim/kompensim” janë vendimet e ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, zyrave rajonale vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”

133/2015⁸, me arsyetimin se këto parashikime ligjore janë konceptuar si një shpronësim i ri, duke qenë se parashikonin rivlerësimin e pronave të kthyera apo kompensuara më parë. Gjykata Kushtetuese (në vijim GJK), ndër të tjera, u shpreh se, në këtë këndvështrim këto dy dispozita krijojnë problem lidhur me sigurinë juridike, konkretisht për sa i përket paqartësisë dhe paparashikueshmërisë së legjislacionit, duke vlerësuar se përmbajtja e pikave 3 dhe 5, të nenit 6, të ligjit nr. 133/2015, nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, pasi përlllogaritja e sipërfaqes së përfituar dhe asaj që do të zbritet ose shtohet sipas formulës së parashikuar në pikën 1 të nenit 6 është e paqartë dhe krijon konfuzion në zbatim sa u takon pritshmërive të shtetasve.⁹ GJK-ja, në vendim, u shpreh, ndër të tjera, se:

“...Omissis...Gjykata lidhur me dispozitat të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, por që ende nuk janë ekzekutuar, vlerëson se ato ngrenë çështjen e “pritsshmërisë legjitime”, por sipas ligjit nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit. Prandaj për këto raste nuk mund të thuhet se ka “ndërhyrje” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të GJEDNJ-së, për sa kohë këto vendime do të ekzekutohen. Për sa u përket vendimeve që përcaktojnë kthimin ose kompensimin vetëm me sipërfaqe dhe jo me vlerë financiare, skema e re e kompensimit, parashikuar nga ligji nr. 133/2015, ndryshoi metodën e vlerësimit, e cila mund të rezultojë në një masë kompensimi më të ulët. Ndonëse masa më e ulët e kompensimit nuk mund të cilësohet si shpronësim formal, ajo mund të cilësohet mjaft mirë si “ndërhyrje të tjera” sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të GJEDNJ-së Megjithatë, Gjykata vlerëson se ekziston një bazë ligjore mjaftueshëm e qartë dhe e detajuar për ndërhyrjen në këtë çështje. Po ashtu, siç u theksua më lart, ndërhyrja duket se ndjek një qëllim legjitim, pasi qëllimi i ligjit nr. 133/2015 është përfundimi efektivisht i procesit të trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes dhe kompensimit të saj brenda afatit të arsyeshëm¹⁰.”

27. Në vijim të këtij arsyeimi, çështja që shtrohet për diskutim para Kolegjit për arritjen në konkluzionin njësuës është në lidhje me kategorinë e vendimeve të mëparshme të organeve administrative kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës, të marra sipas ligjeve të mëparshme të shfuqizuara tashmë, që do t’i nënshtrohen fushës së zbatimit të këtij ligji dhe si rrjedhojë do të vlerësohen financiarisht nga ATP-ja, për të arritur në konkluzionin se cili është ligji i zbatueshëm, cilat vendime do t’i nënshtrohen paraprkasht juridiksionit administrativ për efekt të rivlerësimit financiar dhe kompensimit, cilat mosmarrëveshje do të jenë në juridiksionin gjyqësor dhe cila do të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e atyre mosmarrëveshjeve që janë në juridiksionin gjyqësor. Pra, si duhet kuptuar neni 6/1 e ligjit nr. 133/2015 ku parashikohet se do t’i nënshtrohen vlerësimit të gjitha vendimet e formës së prerë të pakekzekutuara që parashikojnë kthim /kompensim, nëse do t’i nënshtrohen vlerësimit vetëm vendimet e kompensimit të pakekzekutuara dhe të pakekzekutueshme sepse nuk kanë individualizuar në mënyrë konkrete të drejtën e

⁸ Neni 6 i ligjit nr. 133/2015 ka parashikuar se: “1. Për efekt të ekzekutimit, të gjitha vendimet përfundimtare për kthimin dhe kompensimin e pronës do t’i nënshtrohen vlerësimit financiar nga ATP-ja si më poshtë: a) prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit; b) prona e kthyer vlerësohet duke përcaktuar atë nga diferenca që do të rezultojë midis vlerës së kësaj prone, sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit. 2. Vendimet përfundimtare që kanë njohur vetëm të drejtën e kompensimit vlerësohen financiarisht, sipas zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni. 3. Në rastet kur subjektet e shpronësuara kanë përfituar me vendim kthimi dhe kompensimi, diferenca e llogaritur sipas shkronjës “b” të pikës 1, zbritet nga vlerësimi i pronës së njohur për kompensim, e llogaritur sipas shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni. 4. Vlerësimi për vendimin përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit bëhet duke marrë si referim zërin kadastral, sipas origjinës së pronës, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastrale të njëjtit me atë të origjinës së pronës, me distance të njëjta dhe vlera të ndryshme, atëherë për referim në përlllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë. 5. Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet sipas pikës 1 të këtij neni. Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një prone që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së. 6. Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfituar nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfituar më parë, zbritet nga shuma e përlllogaritur për kompensim. 7. Për vendimet e kompensimit të papërcaktuara në vlerë dhe ende të pakekzekutuara, nga periudha e njohjes të së drejtës për kompensim dhe deri në marrjen e shpërblimit, subjektet e shpronësuara do të përfitojnë indeksimin, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesit bankar, sipas mesatares vjetore të ndjerrë nga Banka e Shqipërisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

⁹ Shiko vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, paragrafët 40 dhe 42.

¹⁰ Shiko po aty.

përfshirë në të apo të gjitha vendimet e kthim /kompensimit të paekzekutuara, pavarësisht mënyrës se si është disponuar në to. Si duhet interpretuar kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera të ligjit dhe nën dritën e jurisprudencës së GJK-së dhe GJEDNJ-së.

28. Nga një interpretim sistematik dhe teleologjik i dispozitave të ligjit nr. 133/2015, sikurse u analizua edhe më sipër, ndër të tjera ligji synoi të rregullojë ekzekutimin e vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit, por që nuk janë ekzekutuar sepse nuk parashikonin në mënyrë konkrete modalitetet e kompensimit, duke ia lënë sërish pushtetit ekzekutiv të drejtën për të konkretizuar mënyrën se si do të rivendosej e drejta e ish-pronarëve. Një nga udhëzimet e GJEDNJ-së, në vendimin pilot drejtuar shtetit shqiptar, ishte krijimi i një mekanizmi konkret për vendimet e paekzekutuara, që njihnin të drejtën e kompensimit për vendimet e paekzekutueshme të kthimit apo kompensimit të pronave, për shkak se nuk parashikonin asgjë konkrete në lidhje me të drejtat e ish-pronarit, duke mos individualizuar detyrimin konkret të shtetit dhe të drejtën konkrete në cilësi dhe në sasi të ish-pronarëve. Nën këtë frymë u hartua ligji nr. 133/2015, pikërisht si mjet për të zbatuar udhëzimet e GJEDNJ-së dhe përfundimin e procesit të trajtimit të ish-pronarëve për kompensimin e pronës. Kështu, neni 2, i ligjit nr. 133/2015, ka parashikuar ndër të tjera se:

*“Qëllimi i këtij ligji është: ...b) rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i kompensimit të pronës, **ekzekutimi i vendimeve përfundimtare të kompensimit**¹¹, si dhe përfundimi i procesit të kompensimit, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, nëpërmjet fondit të kompensimit.”.*

Po ashtu, neni 3/2 i ligjit ka parashikuar se:

*“Gjithashtu, ky ligj i shtrin efektet, sa i takon vlerësimit financiar, për: a) **ekzekutimin e të gjitha vendimeve të cilat nuk janë zbatuar, për njohjen e së drejtës së kompensimit**¹², të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore në vendin tonë”.*

Gjithashtu, neni 6 në pikën 1 të tij ka parashikuar se:

*“Për efekt të ekzekutimit të gjitha vendimet përfundimtare për kthimin dhe kompensimin e pronës do t'i nënshtrohen vlerësimit financiar si më poshtë...7) **Për vendimet e kompensimit, të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara** nga periudha e njohjes të së drejtës për kompensim e deri në marrjen e shpërblimit, subjektet e shpronësuar do të përfitojnë indeksimin, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesin bankar, sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.*

Neni 7, pika 2/ç, e ligjit nr. 133/2015, ka parashikuar se:

“...Në rast se vendimi përfundimtar nuk ka vendosur kompensim prone, atëherë vendimi dhe dokumentacioni përkatës arkëvizohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arkivat...”.

Së fundmi, neni 15/1 i ligjit nr.133/2015 ka parashikuar se:

*“Brenda afatit 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe sipas përcaktimeve të tij ATP-ja vlerëson vetëm financiarisht **të gjitha vendimet përfundimtare të pavlerësuar që kanë njohur të drejtën e kompensimit**¹³...”*

29. Qëllimi i ligjit për ekzekutimin e vendimeve të paekzekutuara dhe të paekzekutueshme, për shkak të mënyrës se si është disponuar në lidhje me të drejtat e ish-pronarit, del edhe nga raporti shpjegues dhe shoqërues i projektligjit, ku ndër të tjera është sqaruar se:

“Referuar konkluzioneve të GJEDNJ-së në çështjen Bici kundër Shqipërisë, në lidhje me pretendimet për shkelje të parimit të sigurisë juridike, për shqyrtimin e kërkesave në lidhje me të cilat nuk ka një vendim përfundimtar administrativ apo gjyqësor, mund të thuhet se këto subjekte nuk kanë një pasuri në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. apo nuk kanë krijuar pritshmëri të ligjshme, për sa kohë e drejta e tyre është e papërcaktuar. Kjo pasi legjislacioni i mëparshëm nuk ka krijuar një skemë kompensimi përfundimtare dhe konkrete që të krijonte te subjektet ish-pronare, pritshmëri të ligjshme për vlera konkrete.”¹⁴

¹¹ Theksim i Kolegjit.

¹² Idem.

¹³ Idem.

¹⁴[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2016\)049-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2016)049-e)

30. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së në lidhje me konceptin e pasurisë sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke e elaboruar atë me parimin e pritshmërive të ligjshme dhe sigurisë juridike. Me pasuri në kuptim të nenit 1, të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së do të konsiderohen, jo vetëm pasuritë ekzistuese dhe asetet, por edhe pritshmëritë e ligjshme. Pritshmëritë e ligjshme (të cilat duhet të jetë më konkrete sesa thjesht një shpresë)¹⁵, do të konsiderohen të drejtat e vendosura në mënyrë përfundimtare nga organet administrative dhe gjyqësore dhe vetëm pas këtyre procedurave, çdo ndërhyrje që në mënyrë të padrejtë cenon këtë pasuri, mund t'i japë të drejtën individit të pretendojë shkelje të nenit 1 të KEDNJ-së. Kur interesi pronësor është në natyrën e një ankimi, ai mund të konsiderohet si pasuri vetëm nëse ka bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar, për shembull nëse ka një praktikë të përfunduar të gjykatave të brendshme që e konfirmon atë.¹⁶ Në kuadër të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, GJEDNJ-ja ka theksuar se, shpresa për njohjen e ekzistencës së një të drejte të vjetër mbi pronën, e cila për një kohë të gjatë ka qenë e pamundur të ushtrohej në mënyrë efikase, nuk mund të konsiderohet si “pasuri”, bazuar në interpretimin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shiko çështjen *Bici kundër Shqipërisë*).

31. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka theksuar se vendimet e komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave janë vendime me natyrë *quasi* gjyqësore, të cilat në momentin që marrin formë të prerë janë të detyrueshme për zbatim njëloj sikurse vendimet gjyqësore të formës së prerë. Nga ky moment i lind detyrimi shtetit për të ekzekutuar vendime të tilla. Mbasi kanë marrë formë të prerë ato nuk mund të rishikohen, por vetëm duhet të zbatohen. Karakteri përfundimtar dhe i përhershëm i vendimit gjyqësor nënkupton që rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim¹⁷. Parimi i sigurisë juridike dikton rregullin, që kur mosmarrëveshja civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë dhe nuk duhet të diskutohet apo të vihet në pikëpyetje¹⁸. Një person që ka marrë një vendim kundër shtetit nuk mund të pritët të paraqesë procedura përmbartimore. Barra për të garantuar pajtueshmëri me një vendim kundër shtetit qëndron kryesisht tek autoritetet shtetërore, duke filluar nga data në të cilën vendimi bëhet i detyrueshëm dhe i zbatueshëm.¹⁹

32. Në vijim, Kolegji thekson se nën këtë *ratio* është artikuluar neni 6/7, të ligjit nr. 133/2015, ku është parashikuar se, vendimet e përcaktuara në vlerë, por ende të paekzekutuara do të zbatohen duke u indeksuar sipas vlerës së inflacionit dhe do të paguhet interesat nga momenti i dhënies së vendimit. Sipas relacionit shpjegues, shoqërues të projektligjit:

*“Duke qenë se këto vendime janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme, Agjencia nuk mund të ndryshojë dispozitivin e këtyre vendimeve (referuar edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, e cila i konsideron këto vendime “quasi gjyqësore”), dhe, për këtë arsye, është përcaktuar që vlera e përcaktuar të indeksohet në bazë të vlerës zyrtare të inflacionit dhe të merret e të llogaritet interesi bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.”*²⁰

Po ashtu, nën këtë logjikë juridike, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, ndër të tjera, është shprehur se:

“...Gjykata lidhur me dispozitat që parashikojnë që vendimet gjyqësore apo administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, por që ende nuk janë ekzekutuar, vlerëson se ato ngrenë çështjen e “pritshmërisë legjitime”, por sipas ligjit nuk do t'i nënshtrohen rivlerësimit. Prandaj për këto raste nuk mund të thuhet se ka “ndërhyrje” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të GJEDNJ-së.”

33. Për të njëjtën arsye, ligji nr. 133/2015 ka përjashtuar nga fusha e veprimit edhe vendimet e kthimit fizik të pasurisë së paluajtshme të cilat nuk do të mund të rishikohen dhe rivlerësohen sipas

¹⁵ *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [DHM], nr. 39794/98, GJEDNJ 2002–VII, § 69 dhe *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, § 35, GJEDNJ 2004–IX).

¹⁶ Shiko çështjen “*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*”, paragrafi 137.

¹⁷ Vendim i Gjykatës kushtetuese nr. 23, datë 8.6.2007.

¹⁸ Shiko çështjen “*Kebaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë*”, app no 477 97/99 dhe 68698/01, datë 12.1.2006, të GJEDNJ-së.

¹⁹ Shiko çështjen “*Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës*”.

²⁰ https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/relacioni_trajtimi_i_pronave_24184_1.pdf, faqe 16.

kritereve të ligjit të ri. Ashtu, sikurse vendimet që përcaktojnë të drejtën e kompensimit në masë dhe vlerë konkrete, edhe vendimet e kthimit fizik të pronës janë të vetëkërkueshme për nga mënyra e disponimit dhe njëkohësisht janë tituj pronësie. Kështu neni 7/2/ç i ligjit ka parashikuar se vendimet që nuk njohin kompensim, do të arkivohen sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

34. Më konkretisht, neni 7 ka parashikuar në pikën e parë parimin e përgjithshëm se, do t'i nënshtrohen rivlerësimit vendimet e mëparshme që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe të gjitha vendimet që do merren pas hyrjes në fuqi të ligjit sipas kritereve të këtij ligji. Ndërsa pika e dytë parashikon situatat konkrete sesi do të vihet në zbatim pika e parë e nenit 7, në përputhje me kriteret dhe modalitetet e nenit 6, duke marrë me radhë të gjitha llojet e vendimmarrjeve të organeve administrative të kthimit dhe kompensimit të pronës. Konkretisht kjo dispozitë ka parashikuar se si do të rivlerësohen vendimet që kanë parashikuar kthim dhe kompensim (pika a dhe b), vendimet që nuk kanë vendosur kthim prone, por vetëm kompensim 9 (*shkronja "c"*) dhe vendimet që nuk kanë vendosur kompensim, por kthimin e pronës (*shkronja "ç"*). Nëse tri kategoritë e para do t'i nënshtrohen rivlerësimit nga ATP-ja, kategoria e fundit nuk do të rivlerësohet dhe nuk do të jetë objekt shqyrtimi administrativ nga ATP-ja.

35. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje arsyetimin e pakicës së gjyqtarëve në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese. Ndër të tjera, gjyqtarët e mbetur në pakicë, kur kanë arsyetuar se dispozitat e ligjit nr. 133/2015 cenojnë parimin e sigurisë juridike, janë shprehur se:

"...Në mënyrë të përmbledhur ligji, pavarësisht nga ajo që parashtrohet nga subjektet e interesuara, de facto synon:...
(iii) *pushim të shqyrtimit të kërkesave për të cilat ka një vendim përfundimtar, që nuk ka urdhëruar kompensim të pronës, sipas nenit 7/2 pika ç të ligjit. Nëpërmjet kësaj zgjidhje shteti nuk ka detyrim të zbatojë vendimet përfundimtare të KKKP-së, AKKP-së dhe vendimet gjyqësore që kanë urdhëruar kthimin e pronës..."*

36. Ndryshe nga sa arsyeton pakica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji vlerëson se neni 7/2/ç i interpretuar në këtë mënyrë, pa diskutim që cenon parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës. Në fakt kjo mënyrë interpretimi do të binte ndesh me vetë qëllimin e ligjit nr. 133/2015 dhe vendimin pilot të GJEDNJ-së në çështjen "*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*", si pasojë e të cilit ligji doli. Kolegji rithekson se, ligjit nr. 133/2015 synoi pikërisht t'i japë një zgjidhje përfundimtare procesit të trajtimit të pronës dhe të konkretizojë të drejtat e ish-pronarëve dhe jo të mohojë të drejtat e fituara. Nga të gjitha interpretimet e mundshme të nenit 7/2/ç duhet aplikuar ai që është në pajtim me KEDNJ-në, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJK-së. Kështu kjo dispozitë nuk duhet kuptuar sikur çliron shtetin nga detyrimi për të ekzekutuar vendimet administrative apo gjyqësore përfundimtare, që kanë urdhëruar kthimin e pronës fizikisht. Përkundrazi, interpretimi pajtues me parimin e sigurisë juridike, të drejtat e fituara dhe me të drejtën e pronës, do të ishte që vendimet që kanë urdhëruar kthimin e pronës nuk do t'i nënshtrohen rivlerësimit administrativ për efekt ekzekutimi, pasi ato duke parashikuar të drejta konkrete janë të vetëkërkueshme dhe tituj pronësie. Për këto arsye këto vendime nuk do të rivlerësohen sipas dispozitave të ligjit të ri dhe do të arkivohen, sepse në lidhje me to është eazuruar më parë juridiksioni administrativ. Tek e fundit objekt i ligjit dhe i rivlerësimit administrativ, janë vetëm vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe jo vendimet që kanë urdhëruar kthimin e pronës.

36.1 Në këtë aspekt, Kolegji sjell në vëmendje raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 9377, datë 29.12.2015, Për kthimin e ligjit nr. 133/2015 "*Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave*". Ndër të tjera në këtë raport thuhet se:

"Mundësia e rishikimit të vendimeve nga ana e organit administrativ është përjashtuar në mënyrë kategorike në këtë ligj. Ligji nr. 9235/2004 parashikonte zgjidhje të përkohshme të situatave që lidheshin me kthimin dhe kompensimin e pronës (tranzitore). Pavarësisht kësaj, asnjërit prej aplikantëve të cilët i janë drejtuar Agjencisë me kërkesa të pashqyrtuara, apo që nuk kanë pasur mundësi t'i drejtoheshin deri më sot, nuk u mohohet e drejta e njohjes së

shpërblimit të drejtë për pronën e mobuar. Ashtu sikurse është nënvizuar në raportin e Komisionit të Ligjeve për shqyrtimin e nismës, nënvizojmë se vlerësimi që kryhet nga ATP është vetëm financiar, për ato vendime përfundimtare administrative ose gjyqësore që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe janë të paekzekutuara, në të cilat nuk ka disponim në vlerë financiare...”

37. Sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se ligji nr. 133/2015 nuk synon rishikimin e vendimeve të formës së prerë të kompensimit apo kthimit fizik, ku e drejta e ish-pronarit është përcaktuar në mënyrë konkrete, si në aspektin cilësor dhe si në aspektin sasior, dhe të cilat përfaqësojnë një të drejtë të fituar, qoftë të përmbushura apo qoftë të papërmbushura. Ato janë tituj ekzekutiv, si në rastet kur vishen me formën e aktit administrativ apo kur janë veshur me formën e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe *gjë e gjykuar*, dhe se ato vetëm ekzekutohen dhe nuk mundet të vihen në diskutim apo nuk mundet të rishikohen administrativisht dhe gjyqësisht. Kolegji sjell në vëmendje se edhe ato dispozita që krijonin paqartësi në këtë drejtë, duke parashikuar se mund të rishikoheshin edhe vendimet përfundimtare të kthim/kompensimit, u shfuqizuan nga GJK-ja, e cila ndër të tjera në vendim arsyetoi se:

“... Në këtë këndvështrim këto dy dispozita krijojnë problem lidhur me sigurinë juridike, konkretisht për sa i përket paqartësisë dhe paparashikueshmërisë së legjislacionit, duke vlerësuar se përmbajtja e pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, pasi përlogaritja e sipërfaqes së përfituar dhe asaj që do të zbritet ose shtohet sipas formulës së parashikuar në pikën 1 të nenit 6 është e paqartë dhe krijon konfuzion në zbatim sa u takon pritshmërive të shtetasve...”²¹

Pra, vendimet e kompensimit në vlerë apo në sipërfaqe dhe vendimet e kthimit fizik të pronës, të cilat përcaktojnë në mënyrë konkrete dhe individualizojnë në sasi dhe në cilësi të drejtat e ish-pronarit, nuk do të rishikohen dhe vlerësohen financiarisht nga ATP-ja sipas ligjit të ri, por thjesht do të ekzekutohen nga ana e organeve ligjzbatuese nëse nuk janë ekzekutuar ende. Pretendimet e ish-pronarit në lidhje me vendimmarrje të tilla do të kanalizohen përmes juridiksionit gjyqësor dhe sipas rregullave të përgjithshme që regjojnë aksesin në gjykatë, sepse në lidhje me to është ezauruar më parë *in concreto* juridiksioni administrativ.

38. Nga njëra anë, juridiksioni administrativ, sipas dispozitave të ligjit nr. 133/2015, ka si objekt shqyrtimi vetëm vendimet e pavlerësuar, të cilat parashikojnë të drejta abstrakte (*in abstracto*) dhe nga ana tjetër, nëse do të interpretohej se të gjitha vendimet e mëparshme sipas ligjeve të shfuqizuara tashmë, pavarësisht mënyrës së disponimit, do të bëheshin edhe një herë objekt i ushtrimit të juridiksionit administrativ, kjo do të krijonte sërish zvarritje dhe pasiguri të subjektet titullare dhe do të shkonte përkundër qëllimit të ligjit për përfundimin e procesit të trajtimit të pronës brenda një afati të arsyeshëm me efekt “*bumerang*”. Në këtë kuadër vlen të theksohet se kjo zgjidhje duhet mbajtur parasysh sidomos nga parashikimet e nenit 15, të ligjit nr. 133/2015, i cili parashikon se e drejta e ATP-së, për t’u shprehur në lidhje me vlerësimin financiar të vendimeve të mëparshme, është tre vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, një afat ky i konsiderueshëm në raport me afatin 10-vjeçar të përfundimit të procesit të kompensimit të pronës. Kjo do të thotë se, nëse subjekteve ish-pronare iu ka lindur e drejta e padisë me legjislacionin e mëparshëm, për shkak se në lidhje me to është ezauruar njëherë pushteti administrativ, sipas parimit të sigurisë juridike, kjo e drejtë nuk mund të revokohet apo anulohet me ligj të mëvonshëm dhe nuk mundet dot që sa herë që ndryshon ligji subjektet titullare të një të drejte konkrete të cilëve iu ka lindur e drejta e padisë, të rikthehen në juridiksionin administrativ. Parimi i ndarjes së pushteteve dhe e drejta e aksesit në gjykatë nënkuptojnë se, pasi individ i ketë ezauruar rrugën administrative të detyrueshme për t’u ndjekur sipas ligjit, ai ka të drejtë, që çdo akt të pushtetit publik dhe administrativ, ta sfidojë ligjërisht në pushtetin gjyqësor, për të testuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e mënyrës se si është ushtruar pushteti publik. Kjo do të thotë se, pasi organet administrative të kenë disponuar, të kenë refuzuar për të disponuar, apo të kenë shprehur qartë dhe pa ekuivok qëndrimin e tyre mbi pretendimet e

²¹ Shiko vendim nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, paragrafët 40 dhe 42.

subjekteve titullare të së drejtave apo interesave të ligjshëm, atëherë pushteti administrativ konsiderohet i ezauruar dhe, brenda afateve ligjore të paraqitjes së padisë dhe sipas rregullave të përgjithshme të aktivizimit të juridiksionit gjyqësor, individit mundet të ushtrojë të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë. Ky është parimi dhe zgjidhja ligjore që rendi juridik përdor universalisht në shtetin e së drejtës për të ndarë juridiksionin administrativ me atë gjyqësor. Kolegji Civil vlerëson se, nuk mundet që ndryshimet e ligjit të përtërijnë rrugën administrative të shqyrtimit për një pretendim të një subjekti të së drejtës tashmë të shqyrtuar administrativisht, pasi atij subjekti tashmë i ka lindur e drejta e padisë dhe se e drejta e padisë ushtrohet në juridiksionin gjyqësor, e më konkretisht në gjykatën që ushtron juridiksion fillestar për shqyrtimin e saj dhe të caktuar për këtë qëllim me ligj.

39. Kjo mënyrë interpretimi merr rëndësi akoma më të madhe nëse mbahet parasysh se ligji nr. 133/2015 është miratuar me shumicë të thjeshtë parlamentare dhe potencialisht me të njëjtën shumicë do të mund të ndryshojë, duke bërë të mundur që kërkesat apo pretendimet e ish-pronarëve të qëndrojnë në vazhdimësi, në afate të përcaktuara, por të ndryshueshme me ligj, të varura për shqyrtim para juridiksionit administrativ apo e thënë ndryshe subjekteve që iu ka lindur e drejta me ligj për t'iu drejtuar juridiksionit gjyqësor, në çdo rast me një ligj të mëvonshëm do të mund të riktheheshin në juridiksionin administrativ, sa herë që ligjvënësi do të vlerësojë ripërtëritjen e juridiksionit administrativ. Kjo do të çonte në cenim të sigurisë juridike të subjekteve titullare për mjetet dhe garancitë procedurale për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe ndryshimi i herëpashershëm i afateve, qenia në vazhdimësi para juridiksionit administrativ dhe zvarritjet në rivendosjen e së drejtës, do të cenonin në thelb të drejtën e pronës. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ligji nr. 133/2015 nuk mund të interpretohet se shuan apo të pengon ushtrimin e së drejtës së padisë tashmë të lindur. Përkundrazi, interpretimi pajtues me Kushtetutën i këtij ligji, kërkon detyrimisht që fusha e zbatimit sipas nenit 3 të tij të interpretohet në mënyrë strikte dhe të kufizuar, në respektim të parimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike të individit.

40. Në aspektin material, sigurisht që gëzon mbrojtje për shkak të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës të parashikuar në nenet 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për aq sa është vendosur dhe disponuar me vendimet e mëparshme të organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës. Pjesa e së drejtës e njohur dhe e disponuar me vendim të mëparshëm, sipas ligjit të kohës së marrjes së vendimit, nuk do të cenohet pasi është e drejtë e fituar, por nëse ish-pronari ka pretendime në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të organeve të mëparshme, sipas ligjeve të shfuqizuara, në lidhje me cilësinë apo sasinë e së drejtës së fituar, për pjesën e së drejtës së pretenduar do të zbatohen dispozitat e ligjit të ri dhe kufizimet e parashikuara në të në lidhje me kthimin fizik të pronës. Vlen të theksohet se padi të tilla ngrihen në një kontekst të ri ligjor, në një kohë që ka hyrë në fuqi një ligj i ri, që rregullon ndryshe marrëdhënien midis shtetit dhe ish-pronarit, në mënyrë më të disfavorshme, por që sipas opinionit të Komisionit të Venecias²² dhe vendimit të GJK-së, ndjek një qëllim legjitim dhe ky rregullim ndryshe i ligjit e ka kaluar tashmë testin e proporcionalitetit të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë edhe testin e përgjithshëm të kushtetutshmërisë së kufizimit ligjor të së drejtës. Në këtë aspekt, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga GJK-ja, në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, në lidhje me mosparashikimin e kthimit fizik të pronës dhe vlerësimit të saj sipas vlerës në kohën e shpronësimit. Ndër të tjera kjo gjykatë është shprehur se:

“...Nisur edhe nga analiza e Komisionit të Venecias, Gjykata vlerëson se ligji objekt shqyrtimi pavarësisht se parashikon një metodologji të re vlerësimi për kompensimin fizik dhe financiar të ish-pronarëve, e cila megjithëse rezulton në nën hyrje në të drejtën e pronës dhe mund të mos u përgjigjet pritshmërive të subjekteve që prek ligji, rezulton se në tërësinë e tij respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës së ish-pronarëve dhe si e tillë është në respektim të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së...”

²² Shih opinionin e Komisionit të Venecias nr. 861/ 2016, CDL-AD (2016)023.

40.1 Në vijim të kësaj analize Kolegji thekson se, nga njëra anë pritshmëritë e ligjshme dhe siguria juridike nuk nënkuptojnë dhe nuk mbulojnë mungesën e dilijencës së ish-pronarit, i cili për një kohë të gjatë, deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, nuk i ka parashtruar dhe kontestuar më parë pretendimet e tij për paligjshmëri të vendimit të organit administrativ të kthimit dhe kompensimit të pronës, sipas parashikimeve të ligjit të kohës kur është marrë vendimi. Nga ana tjetër, parimi i sigurisë juridike nuk nënkupton mosndryshimin e legjislacionit apo mosndryshimin e një situate të mëparshme. Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të. Nga ana tjetër, kërkohet që ligjit të mos qëndrojë statik, nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike. Në këtë pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Jo çdo masë me efekte negative që merr ligjvënësi për subjektet e ligjit është cenim i një të drejte të garantuar me Kushtetutë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta, të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme, nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi (*shih vendimin nr. 37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se vendimet e kompensimit të organeve të mëparshme, të papërcaktuara në vlerë nuk mund të kualifikohen si pritshmëri të ligjshme konkrete në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Duke mos pasur të individualizuar konkretisht të drejtën e përfshirë në të, nuk mund të thuhet se ato përfaqësojnë një të drejtë të fituar. Nisur nga natyra e disponimit, mund të thuhet se ato vendime krijojnë një të drejtë të papërcaktuar dhe mund të barazohen për nga pasojat me kategorinë e subjekteve që nuk janë trajtuar me vendim të mëparshëm. Në këtë aspekt, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e GJEDNJ-së në çështjen Bici Kundër Shqipërisë, ku GJEDNJ-ja ndër të tjera është shprehur se:

“Këta individë apo entitete nuk janë pronarë dhe nuk kanë krijuar pritshmëri të ligjshme pasi e drejta e tyre nuk është njohur në nivel kombëtar.”.

Po ashtu, referuar relacionit shpjegues shoqërues të projektligjit në Kuvend, nuk është hartuar asnjëherë ndonjë skemë e qartë përfundimtare kompensimi, me një shifër konkrete kompensimi e cila do të krijonte një pritshmëri legjitime.

41.1 Sa më sipër, këto kategori vendimesh do t'i nënshtrohen vlerësimit financiar nga juridiksioni administrativ, i cili do të duhet të konkretizojë dhe të perfeksionojë të drejtat e ish-pronarëve të njohura në mënyrë hipotetike dhe më tej do t'i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor sipas kriterëve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 133/2015. Arsyeja pse këto vendime do të trajtohen paraprakisht nga juridiksioni administrativ është sepse, mund të thuhet se, në lidhje me to nuk është ezauruar më parë ky juridiksion. Vendimet që njohin të drejtën e kompensimit në mënyrë të papërcaktuar, që për efekt të ligjit do të konsiderohen të pavlerësuar, barazohen, për nga efektet dhe pritshmëritë që ato krijojnë te subjektet titullare, me ato që nuk i janë nënshtrohur ende juridiksionit administrativ, duke qenë se në lidhje me to ky juridiksion nuk ka pasur një disponim konkret. Si rrjedhojë ky i fundit, nuk do të mund të konsiderohet i ezauruar paraprakisht, si *condicio sine qua non*, për lindjen e së drejtës së padisë. Kjo do të thotë se, nëse mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit lidhet me një të drejtë të papërcaktuar, ajo do të qëndrojë para juridiksionit administrativ, i cili do të duhet të bëjë konkretizimin dhe perfeksionimin e së drejtës dhe nëse është për një të drejtë të përcaktuar në mënyrë konkrete, atëherë ajo do të shqyrtohet para juridiksionit gjyqësor, sepse konsiderohet se në lidhje me të është ezauruar një herë juridiksioni

administrativ.

42. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji vlerëson se, për shqyrtimin e çdo mosmarrëveshjeje, që do të gjenerojë nga vendime të organeve të mëparshme administrative, të cilat kanë disponuar në mënyrë konkrete për të drejtat e ish-pronarit, kompetente do të jetë gjykata e apelit, në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm, sipas rastit gjykata e apelit civil kur pretendimet dhe mosmarrëveshja buron nga njohja e së drejtës (neni 29 i ligjit) dhe për kontestimet për kompensimin financiar mosmarrëveshjet do të jenë në kompetencë të Gjykatës Administrative të Apelit (neni 19 i ligjit). Kolegji vlerëson se, edhe pse ligji nr. 133/2015 nuk parashikon në mënyrë të shprehur se në kompetencë së cilës gjykate do të jetë shqyrtimi i vendimeve të mëparshme të organeve administrative të kthimit dhe kompensimit të pronës, kjo buron nga qëllimi i ligjit dhe objekti i tij, që është jo vetëm ekzekutimi i vendimeve të paekzekutuara, por edhe përfundimi i procesit të trajtimit të pronës, sa më shpejt dhe brenda një afati të arsyeshëm.

43. Kolegji vlerëson se me qëllim përfundimin brenda një afati të arsyeshëm të procesit kthimit të pronave, ligjvënësi ka parashikuar vetëm një shkallë gjykimi nga pikëpamja e faktit dhe e ligjit, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve që disponojnë në lidhje me pronën e ish-pronarëve, konkretisht Gjykatën e Apelit. Pra, ligji ka parashikuar një shkallë shqyrtimi administrativ me juridiksion fillestar fakti dhe ligji, një shkallë shqyrtimi gjyqësor, konkretisht gjykata e apelit, me juridiksion rishikues të plotë fakti dhe ligji dhe një shkallë shqyrtimi gjyqësor, konkretisht Gjykata e Lartë, me juridiksion të plotë rishikues dhe ekskluziv ligji. Kështu, në pikëpamje të ezaurimit të shkallëve të gjyqësorit mund të thuhet se ATP-ja merr disa tipare të një *quasi* gjykate dhe vendimi i saj merr tiparet e një *quasi* vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë²³, për efekt të ushtrimit të juridiksionit fillestar mbi kërkesat për trajtimin e pronës. Megjithatë, ATP-ja, duke qenë në varësi të ministrit të Drejtësisë, nuk plotëson kushtet materiale kushtetuese dhe konventore të *quasi* gjykatës dhe për rrjedhojë edhe vendimet e saj nuk janë vendime *quasi* gjyqësore. Kolegji konkludon se eliminimi i një shkalle të ushtrimit të pushtetit gjyqësor (shiko nenin 135 të Kushtetutës) garanton synimin e ligjvënësit për të përfunduar të gjithë procesin e trajtimit të pronave brenda 10 viteve, me qëllim moszvarritjen e këtij procesi pafund në nivele të ndryshme të juridiksionit administrativ dhe pushtetit gjyqësor.

44. Në lidhje me mënyrën se si ka disponuar ligjvënësi për të drejtën e ankimit ndaj këtyre vendimeve, GJK-ja, është shprehur se ai është në përputhje me nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me nenin 13 të KEDNJ-së. Më konkretisht në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

“E drejta e ankimit e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 i plotëson kriteret për të pasur një kontroll gjyqësor të akteve të nxjerra nga organe administrative ose kuazi gjyqësore...Gjykata thekson se shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së...”

45. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se me ligjin nr. 133/2015, kompetente për të shqyrtuar pretendimet në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të ATP-së, për njohjen e së drejtës së pronësisë ish-pronarëve apo vendimeve të ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronës, ish-zyrave rajonale vendore të kthimit dhe kompensimit të pronës apo ish-Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, personaliteti juridik i së cilës i ka kaluar ATP-së, do të jetë Gjykata e Apelit.

Sipas objektit të mosmarrëveshjes, nëse pretendimet lidhen me njohjen e së drejtës, gjykatë kompetente sipas nenit 29 do të jetë Gjykata e Apelit në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm objekt vendimmarrjeje (*forum rei sitae*). Nëse pretendimet lidhen me vlerën e kompensimit, gjykatë kompetente do të jetë Gjykata Administrative e Apelit.

Ky ka qenë qëllimi i ligjit nr. 133/2015, konkretisht i neneve 19 dhe 29 të tij kur ka përcaktuar

²³ Kuptohet jo në kuptimin e mirëfilltë të organit kuazi gjykatë, me të gjitha elementet që një organ duhet të plotësojë për të qenë i tillë sipas jurisprudencës të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo pasi këtij organi i mungon elementi i pavarësisë nga pushteti ekzekutiv. Sipas nenit 26/1, të ligjit nr. 133/2015, ATP-ja varet nga ministri i Drejtësisë.

kompetencën funksionale të gjykatave të apelit për kontrollin gjyqësor ndaj vendimeve të ATP-së. Po ashtu, ky ka qenë qëllimi i këtij ligji, konkretisht në nenet 32 dhe 38 të tij, si dispozita kalimtare, për të përcaktuar kompetencën funksionale të gjykatave të apelit edhe për kontrollin gjyqësor të vendimeve të mëparshme të KKKP-ve, ZRVKKP-ve apo AKKP-së, duke parashikuar shuarjen e personalitetit juridik të AKKP-së, kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të saj ATP-së dhe duke shfuqizuar ligjet e mëparshme që binin ndesh me këtë ligj, të cilat regionin veprimtarinë e mëparshme të këtyre organeve dhe të cilat parashikonin rrugën e zakonshme gjyqësore të kundërshtimit të vendimeve të këtyre organeve.

46. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji thekson se nga njëra anë ky interpretim është në përputhje me *ratio*-n e ligjit nr. 133/2015, i cili synon përfundimin e procesit të kthimit të pronës sa më shpejt dhe brenda një afati të arsyeshëm, duke shmangur zvarritjet e procedimit administrativ dhe gjyqësor në përfundimin e procesit të trajtimit të pronës. Nga ana tjetër ky interpretim është pajtues edhe me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në. Kjo pasi individit i garantohet akses i pakten një gjykatë që plotëson standardet e nenit 6 të KEDNJ-së dhe po ashtu i garantohet e drejta për ankim efektiv, sikurse është shprehur GJK-ja në vendimin e cituar më sipër. Në këtë mënyrë ky interpretim jo vetëm që nuk cenon të drejtat e subjekteve që u drejtohen këtyre organeve, por garanton shpejtësinë dhe efektivitetin në procesin e njohjes dhe kthimit të pronës.

47. Nga analiza e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludoi në sentencën e parë të këtij vendimi njësuës të praktikës gjyqësore, duke vendosur se:

Për shqyrtimin e padive të regjistruara në gjykatë pas datës 23.2.2016, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr. 133/2015, të paraqitura nga subjekti ish-pronar apo trashëgimtarë të tij, kundër vendimit të dhënë nga ish-KKKP-të, ish-ZRVKKP-të apo ish-AKKP-ja, që ka disponuar në lidhje me kërkesën e tyre, në bazë të ligjeve të mëparshme për kthimin dhe kompensimin e pronës, gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore /funksionale do të jetë Gjykata e Apelit.

Për sa u përket kërtimeve për njohjen e së drejtës, kompetente nga pikëpamja lëndore/funksionale është Gjykata e Apelit në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm. Ndërsa për sa u përket kërtimeve për vlerën e kompensimit, kompetente nga pikëpamja lëndore/funksionale është Gjykata Administrative e Apelit.

B. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

Cila është gjykata kompetente, për shqyrtimin e padisë, të kundërpadisë apo të padisë së ndërhyrësit kryesor, me të cilat, kundërshtohet vendimi i ish-KKKP-së, ish-ZRAKKP-së apo ish-AKKP-ja dhënë në favor të një subjekti, nga i cili pretendon tërësisht apo pjesërisht për vete dhe në cilën gjykatë kundërshtohet ky vendim si titull pronësie?

48. Për të konkluduar mbi këtë çështje të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson të marrë në analizë fillimisht natyrën juridike të marrëdhënies midis shtetit dhe ish-pronarit, në kuadër të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës dhe të marrëdhënies midis ish-pronarit dhe subjekteve të tjera ish-pronare ose jo, të cilët pretendojnë të drejta pronësie mbi një pasuri të paluajtshme, për të cilën ka disponuar një herë me vendim përfundimtar organi kompetent për kthimin dhe kompensimin e pronës apo edhe gjykata. Kualifikimi i drejtë i secilës nga këto marrëdhënie juridike, do të duhet të mbahet parasysh nga çdo gjykatë, që shqyrton mosmarrëveshje të ngjashme, si për të vlerësuar apo kualifikuar drejtë çështjen e kompetencës lëndore/funksionale në shqyrtimin e këtyre çështjeve, ashtu edhe për të orientuar palët në formimin e rregullt të ndërgjyqësisë në konfliktet eventuale gjyqësore.

49. Fillimisht, Kolegji vlerëson se ligji nr. 133/2015, ashtu sikurse edhe ligjet e mëparshme të shfuqizuara tashmë, me objekt procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës ish-pronarëve, e kanë shtrirë fushën e veprimit të subjektet ish-pronare, të cilat në mënyrë të padrejtë janë shpronësuar apo ju është konfiskuar prona me akte administrative apo vendime gjyqësore, nga shteti komunist totalitar prej datës 29.11.1944. Qëllimi i ligjvënësit, ndër vite, ka qenë, që nëpërmjet procesit të “*vetëshpronësimit*”, të rregullonte dhe disiplinonte marrëdhënien midis ish-pronarit dhe shtetit, të përfaqësuar nga organet kompetente administrative të kthimit dhe kompensimit të pronës, duke marrë përsipër detyrimin për të rregulluar dhe reduktuar, për aq sa ka qenë e mundur, brenda kushteve ekonomiko-sociale, padrejtësitë e sistemit

të mëparshëm, bazuar në parimet e barazisë, proporcionalitetit, drejtësisë dhe shtetit social.

50. Detyrimi i shtetit shqiptar, ashtu sikurse edhe i të gjitha shteteve të tjera të Evropës Qendrore dhe lindore të tranzicionit post-komunist, që iu nënshtruan procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës, nuk e kishte burimin e legjitimitetit nga neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ashtu sikurse GJEDNJ-ja është shprehur në shumë raste, neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të interpretohet sikur vendos një detyrim të përgjithshëm ndaj shteteve, palë të larta kontraktuese, për të kthyer pronën që u ishte transferuar atyre para se ta ratifikonin KEDNJ-në. Por nga ana tjetër, nëse një shtet kontraktues që ka ratifikuar Konventën, duke përfshirë protokollin nr. 1, miraton legjislacionin që parashikon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar sipas një regjimi të mëparshëm, ky legjislacion dhe për rrjedhojë edhe ai shtet mund të konsiderohet se sjell një të drejtë pronësie të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr. 1, për personat që përmbushin kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit.²⁴ Nuk mund të vendosen detyrime për kompensimin tërësor të pronës së shpronësuar apo të shtetëzuar nga regjimet, që nuk kanë respektuar standardet minimale të të drejtave të njeriut, dhe se rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vetë parimin e barazisë.²⁵ E thënë ndryshe, procesi i vetëdetyrimit të shtetit për të rregulluar padrejtësitë e sistemit shtetëror totalitar e ka pasur bazën në parimet e shtetit social dhe të drejtësisë dhe nuk ka synuar reduktimin e plotë të të gjitha padrejtësive dhe pasojave negative. Pasojat negative janë synuar të reduktohen për aq sa është e mundur, duke ruajtur edhe një balancë midis interesave të ish-pronarëve dhe interesave të shoqërisë në tërësi.

51. Në të njëjtën linjë arsyetimi, GJK-ja ka mbajtur qëndrimin se procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave është vazhdim i disa proceseve paralele të ndërmarra nga shteti për vetëshpronësimin e tij në favor të privatëve. Shteti nuk u shpronësua menjëherë nga pasuritë, të cilat në atë kohë figuronin “*de jure*” në pronësi të tij. Kështu, në këtë frymë ligji për kthimin e pronës përshkohet nga parimi sipas të cilit shteti merr përsipër (detyron vetveten) t’u kthejë ish-pronarëve, d.m.th., t’i ripronësojë ata me ato prona që faktikisht dhe juridikisht është e mundur të kthehen, mbasi ekzistojnë efektivisht e janë në fondin e pronësisë shtetërore, ose mbahen pa arsye të përligjura nga të tjerët²⁶. Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, ish-pronarëve u ka humbur e drejta e pronës nga shpronësimet e rendit juridik të mëparshëm, të kryera nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore ose vendimeve gjyqësore. Ky konkluzion përbën arsyen që këta persona, duke mos gëzuar në vijimësi pronat e tyre në cilësinë e pronarit kërkojnë që, nëpërmjet procedurës së kthimit dhe kompensimit të pronës, të rifitojnë këtë cilësi.

52. Sa më sipër, Kolegji dedukton se, mbrojtja e së drejtës së pronës, në aspektin kushtetues dhe të së drejtës ndërkombëtare, nuk garanton kthimin e pronës të konfiskuar sipas sistemeve apo regjimeve totalitare²⁷. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës në vendet e tranzicionit post-komunist bazohet sa në të drejtën e pronës, po aq edhe në parimet e drejtësisë dhe ndershmërisë, mbi të gjitha në parimet e shtetit social. Kjo do të thotë se e drejta e pronës nuk barazohet me të drejtën e kthimit/apo kompensimit. Neni 1, i protokollit nr.1, të KEDNJ-së, mbron vetëm pasurinë ekzistuese dhe nuk garanton të drejtën për të fituar pasuri. Por, nga ana tjetër nëse sipas legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, e drejta hipotetike për kthim apo kompensim e ish-pronarit është shndërruar në një pritshmëri të ligjshme konkrete, ajo do të konsiderohet aset në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe si rrjedhojë gëzon mbrojtje sipas këtij parashikimi konventor.

53. Sikurse u analizua edhe në çështjen e parë të këtij vendimi njësuës, sipas jurisprudencës të

²⁴ Shiko vendimin, datë 31.7.2012, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “Manushaqe Puto kundër Shqipërisë”, paragrafët 135–136.

²⁵ Opinion mbi projektligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të Republikës së Shqipërisë”, të miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e 58-të plenare Venecia, 12–13 mars 2004).

²⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 4, datë 8.4.1994, Përmbledhje e vendimeve, viti 1992–1996, faqe 111–113.

²⁷ [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2016\)049-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2016)049-e)

GJEDNJ-së koncepti i pasurisë ka një parashikim autonom, i cili është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendas.²⁸ Pasuri në kuptim të nenit 1, të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së janë “pasuritë ekzistuese” “asetet” ashtu edhe “pritshmëritë e ligjshme”²⁹. Në kuadër të legjislacionit me objekt kthimin dhe kompensimin e pronës, pritshmëria e ligjshme (e cila duhet të jetë më konkrete sesa thjesht një shpresë)³⁰, do të konsiderohet ajo çka është vendosur në mënyrë përfundimtare nga organet administrative dhe gjyqësore dhe vetëm pas këtyre procedurave, çdo ndërhyrje që në mënyrë të padrejtë cenon këtë pasuri, mund t’i japë të drejtën individit të pretendojë shkelje të nenit 1 të KEDNJ-së. Vetëm nga ky moment do të mund të aktivizohen të gjitha mjetet e mbrojtjes së pronësisë sipas legjislacionit vendas. Nga ana tjetër, shpresa për njohjen e ekzistencës të një të drejte të vjetër mbi pronën, e cila për një kohë të gjatë ka qenë e pamundur të ushtrohej në mënyrë efikase, nuk mund të konsiderohet si “pasuri”, bazuar në interpretimin e nenit 1, të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së.

54. Duke iu referuar këtij koncepti konventor, kushtetues dhe jurisprudencial të pasurisë, Kolegji vlerëson se, marrëdhënia juridike që ka lindur midis shtetit dhe ish-pronarit ka qenë dhe është një marrëdhënie e një natyre të veçantë “*sui generis*”, me elemente sa juridiko-administrative, po aq edhe juridiko-civile. Aspekti juridiko-administrativ lidhet me faktin se në lidhje me të drejtën e ish-pronarit do të vendosë një organ i administratës publike, përfaqësues i shtetit pronar, kompetencat e të cilit janë përcaktuar me ligj të veçantë dhe i cili do ta artikulojë vullnetin e tij me një akt administrativ. Tek e fundit, kjo është forma me të cilën shteti operon, si një ent publik i cili shpreh vullnetin e tij nëpërmjet akteve apo veprimeve administrative. Nga ana tjetër, aspekti juridiko-civil, lidhet me faktin se pretendimet e ish-pronarit, i cili i drejtohet organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës lidhet me një të drejtë subjektive në kuptim të neneve 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe 32 të KPC-së. E drejta e një personi për t’u njohur pronar mbi një send rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil, gjë që del jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike, që rregullon veprimtarinë e organeve të administratës publike, në mbrojtje të interesit publik.³¹ Vendimet e organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës, kanë disponuar drejtpërsëdrejti mbi të drejta subjektive, të cilat kanë qenë ekskluzive të titullarëve të caktuar dhe jo të shtetasve apo publikut në tërësi siç janë interesat publike. Për këtë arsye, vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, që kanë njohur dhe kthyer pronën ish-pronarit, nuk janë akte administrative, në kuptimin klasik, normal dhe të zakonshëm juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, për të cilin GJEDNJ-ja ka përdorur termin e ri leksikor, *quasi gjykatë*³². Ky konkluzion do të thotë se, në rastet kur kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror ka shprehur vullnetin e vet nëpërmjet akteve, këto të fundit nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte.

55. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se në momentin që vendime të tilla marrin formë të prerë, shteti konsiderohet i vetëshpronësuar dhe ato shndërrohen në tituj pronësie (mënyra të fitimit të pronësisë), për subjektin në favor të të cilit është disponuar, në kuptim të nenit 163, të Kodit Civil, pronë në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe pasuri në kuptim të nenit 1, të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së. Nga momenti i marrjes formë të prerë të vendimeve të organeve administrative të kthimit dhe kompensimit të pronës, ndodh zhveshja si titullar i së drejtës së pronës së shtetit dhe lindja e së drejtës së pronës të ish-pronarit apo trashëgimtarit të tij. Kjo do të thotë, se nga momenti i vetëshpronësimit të shtetit, me anë të një vendimi të formës së prerë, që njeh dhe kthen pasurinë e

²⁸ Shiko çështjen ish-mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë [GC], nr. 25701/94, § 60 GJEDNJ 2000–XII

²⁹ Shiko çështjen “*Bici kundër Shqipërisë*”

³⁰ Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (vendim) [DHM], nr. 39794/98, GJEDNJ 2002–VII, § 69 dhe Kopecký kundër Sllovakisë [DHM], nr. 44912/98, § 35, GJEDNJ 2004–IX).

³¹ “*Ališić and others v. Bosnia-Herzegovina, Kroacia, Serbia, Sllovenia dhe FYROM*” Grand Chamber datë 16.7.2014, §108

³² Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese 27/2010.

paluajtshme apo e kompenson atë me një pasuri tjetër, në favor të ish-pronarit, qoftë ky vendim i bazuar në ligj apo jo, të gjitha pretendimet e subjekteve të treta në qarkullimin civil në lidhje me atë pasuri apo të gjitha mosmarrëveshjet që mund të gjenerojnë këto vendime (tituj pronësie), nuk do të kualifikohen më si mosmarrëveshje me natyrë mikse administrativo-civile midis shtetit dhe ish-pronarit në kuadër të procesit të njohjes dhe kthimit të pronës, por do të konsiderohen si mosmarrëveshje me natyrë tipike juridiko-civile, midis subjekteve të së drejtës private, ish-pronarë ose jo që pretendojnë mbrojtjen e të drejtave subjektive të pronësisë mbi një send të paluajtshëm, të cilët në një konflikt eventual, do t'i nënshtrojnë debatit gjyqësor, ekzistencën dhe vlefshmërinë e titujve respektivë të pronësisë, sipas normave juridike të së drejtës civile, procedurale dhe materiale.

56. E thënë ndryshe shtetit nuk mund t'i kërkohet më gjyqësisht apo edhe jashtëgjyqësisht, nga subjektet e treta që pretendojnë të drejta pronësie mbi një send të paluajtshëm, një detyrim për njohje pronar apo kthim sendi, sepse duke u vetëshpronësuar një herë, shteti nuk është më titullar i asaj pasurie, e ka humbur pronësinë mbi atë send dhe rrjedhimisht as nuk mund të disponojë më mbi të, sipas parimit se askush nuk mund t'i japë një tjetri më shumë të drejta nga sa ai ka (*nemo dat quod non habet*).

57. Në të njëjtën logjikë juridike, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kur kanë kualifikuar marrëdhënien midis të tretit, shtetit dhe ish-pronarit për efekt të ezaurimit të ankimit administrativ, për kundërshtimin e vendimeve të organeve administrative kompetente të kthimit dhe kompensimit të pronës, ndër të tjera me vendimin nr. 2, datë 21.1.2011, janë shprehur se:

“Subjektet e shpronësuar kanë detyrimin që t'i drejtohen organit administrativ, pra AKKP-së në dy situata: së pari, në rastin kur subjektet e shpronësuar paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës në cilësinë e ish-pronarit. Së dyti, në rastin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në emër të tyre dhe mbi kërkesën e tyre nga (ish-) Zyra Rajonale e AKKP-së, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar). Gjithsesi, edhe në këto dy raste, çështja do bëjë pjesë në juridiksionin gjyqësor, pra detyrimi për t'iu drejtuar rrugës përkatëse administrative të kërkesës dhe ankimit nuk ekziston nëse nga subjekti i shpronësuar pretendohet që për të njëjtën pronë, ish-KKKP-të apo AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimit të pronës një subjekti tjetër të shpronësuar.”

Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se në momentin kur shteti nëpërmjet ish-KKKP-ve, ish-ZRAKKP-ve apo ish-AKKP-së është vetëshpronësuar me një vendim, mosmarrëveshja që mund të lindë midis subjektit në favor të të cilit është dhënë vendimi dhe të tretit i cili mund të ketë pretendime mbi atë send të paluajtshëm në cilësinë e ish-pronarit, nuk është më një mosmarrëveshje administrative-civile (*sui generis*) midis shtetit dhe ish-pronarit, e cila duhet të zgjidhet paraprakisht nga juridiksioni administrativ. Tashmë kjo mosmarrëveshje civile ka lindur dhe ekziston ndërmjet dy subjekteve të së drejtës private dhe si e tillë duhet të zgjidhet drejtpërdrejtë para juridiksionit gjyqësor.

58. Po ashtu, GJK-ja, në vijimësi ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me legjitimitetin e këtyre subjekteve për t'iu drejtuar gjykatës për pretendimet e tyre në lidhje me të drejtat e pronësisë mbi sende të paluajtshme objekt vendimarrjeje nga organet kompetente të kthimit dhe kompensimit të pronës. Kështu, në vendimin nr. 27, datë 27.7.2009, GJK-ja ka arsyetuar se:

“Legjitimiteti i këtyre subjekteve, si pjesë e praktikës së zakonshme gjyqësore, është pranuar dhe nga Gjykata e Lartë, që sipas nenit 141/2 të Kushtetutës ka bërë njësimin e praktikës gjyqësore. Gjatë gjykimit të inicuar prej subjekteve të mësipërme, përveç të tjerave, hetohet dhe vërtetohet dhe fakti nëse këtyre subjekteve u është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe, çdo vendim gjykate që do të anulonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës së administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tyre të pronësisë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e inicuar nga të tilla subjekte, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre.”

Po ashtu, ky qëndrim konsolidohet më tej, konkretisht me vendimin 27/2010 të GJK-së, ku ndër të tjera ajo është shprehur se:

“...në rastet kur kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror ka shprehur vullnetin e vet nëpërmjet akteve, këto të fundit nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte...gjykatat e Republikës së Shqipërisë, në momentin që investoheshin për të zgjidhur ankimet në lidhje me vendimet e KKKP-së, e zgjidhnin çështjen në themel njësoj sikur të ndodheshin para një konflikti të mirëfilltë pronësie.”.

59. Kolegji thekson se në aspektin ngushtësisht teknik-procedural paditë e subjekteve të treta me objekt kundërshtimin e vendimeve të kthimit apo kompensimit të pronës (kompensimit fizik) gjenerohen dhe e kanë bazën në nenet 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 296 e vijues të Kodit Civil apo padi të tjera, si p.sh. paditë e njohjes dhe kthimit të pasurisë trashëgimore apo njohjes së bashkëpronësisë. Konkretisht, neni 31 ka parashikuar se:

“Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t’u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi.”.

Po ashtu, neni 32 i K.Pr.Civile, ka parashikuar se:

“Padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur; b) për vërtetimin e genies ose mosgenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.”

Nenet 31 dhe 32 konkretizojnë në terrenin ligjor parashikimin e përgjithshëm kushtetues të nenit 42 të Kushtetutës, që përcakton juridiksionin e përgjithshëm dhe detyrues gjyqësor, sipas të cilit kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të veta kushtetuese ka të drejtën t’i drejtohet një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj.

60. Në bazë të dispozitave të sipërcituara, kushdo për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë mbi një send të paluajtshëm, mund t’i drejtohet gjykatës, duke shfrytëzuar një nga mjetet e mbrojtjes së pronësisë dhe, mund të kërkojë të njihet pronar mbi sendin e paluajtshëm (me padi njohjeje, *formulae praeiudiciales*) apo edhe t’i kthehet ky send (*rei vindicatio* apo *petitum hereditatis*). Nga ana tjetër, personi kundrejt të cilit drejtohet ky kërkim ka të drejtë të mbrohet, qoftë nëpërmjet prapësimit apo qoftë nëpërmjet kundërpadisë, duke kundërshtuar ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e titullit të pronësisë të palës kundërshtare.³³ Në raste të tilla, kundërshtimi i vendimit të ish-KKKP-ve, ish-AKKP-së apo ish-ZRAKKP-ve, si në situatën kur paditësi kundërshton titullin e pronësisë së palës së paditur ashtu edhe kur pala e paditur kundërshton titullin e pronësisë së paditësit, është në themel të arsyes juridike dhe shkakut ligjor të padisë apo të kundërpadisë. Gjykatat në mosmarrëveshje të tilla, do të ushtrojnë kontroll incidental mbi ligjshmërinë e këtyre vendimeve, si një çështje paragjykimore, me qëllim që të vlerësojë bazueshmërinë e pretendimit të paditësit, të ndërhyrësit kryesor apo palës së paditur kundërpaditëse eventualisht për njohje pronar apo për kthim sendi.

61. Pra, kur kemi të bëjmë me padi, kundërpadi apo padi të ndërhyrësit kryesor që synojnë të godasin si tituj pronësie vendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave të një subjekti tjetër, me pretendimin se organet administrative kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës, duke shkelur ligjin kanë disponuar pronën që duhej ta përfitonte paditësi, i padituri kundërpaditës apo ndërhyrësi kryesor, gjykata ka rolin e vlerësuesit të zbatimit të ligjit mbi komisionin përkatës apo mbi agjencinë ligjzbatuese përkatëse. Nën këtë regjim juridik do të testohet ligjshmëria e titujve kundërthënës të pronësisë midis ndërgjyqësve në funksion të zgjidhjes përfundimtare të konfliktit objekt gjykimi dhe të disponimit mbi të gjitha kërkimet e padisë, të kundërpadisë, apo të padisë së ndërhyrësit kryesor. Kjo do të thotë, nga njëra anë, se titujt e pronësisë të palëve ndërgjyqëse do të shqyrtohen, jo si akte administrative, por si tituj pronësie të zakonshëm dhe, nga ana tjetër, diskutimi mbi procesin djallëzor të provueshmërisë (*probatio diabolica*) nuk do të shtrihet në titujt e pronësisë

³³ Pretendimi për pavlefshmëri absolute të vendimit të organit kompetent për kthimin dhe kompensimin e pronës mund të paraqitet edhe në formën e prapësimit nga pala e paditur.

origjinar apo titujt e pronësisë zinxhir të trashëgimtarëve të ndërgjyqësve, përkundrazi, titujt e tyre të pronësisë do të analizohen në funksion të testimi të provueshmërisë dhe përmbushjes së kriterëve ligjore të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës. Nga ky konkluzion do të formësohet edhe mënyra e disponimit mbi kërkimet e padisë, të kundërpadisë apo të padisë së ndërhyrësit kryesor.

62. Sipas ligjit nr. 133/2015, në kompetencën funksionale të gjykatave të apelit janë vetëm mosmarrëveshjet që lindin midis subjekteve ish-pronare dhe shtetit të përfaqësuar nga Agjencia e Trajtimit të Pronës dhe ku objekt shqyrtimi gjyqësor është ligjshmëria e vendimmarrjes së organit kompetent për kthimin apo kompensimin e pronës, në lidhje me të drejtat e pronësisë së ish-pronarëve, me qëllim përfundimin e procesit të trajtimit të pronës. Nga momenti i marrjes formë të prerë të këtij vendimi, ndodh zhveshja si titullar i së drejtës së pronës së shtetit dhe lindja e së drejtës së pronës së ish-pronarit. Me këtë vendim, shteti është vetëshpronësuar dhe është çliruar nga detyrimi i tij për kthimin e pronës ndaj ish-pronarëve dhe trashëgimtarëve të tyre.

Padrejtësitë në pjesët takuese të trashëgimtarëve apo subjekteve të tjera apo paligjshmëria e këtij vendimi, nuk mund të jenë më detyrime të shtetit karshi tyre por janë mosmarrëveshje civile që duhet të zgjidhen ndërmjet tyre nga gjykata.³⁴ Në padi të tilla me objekt njohje pronar, bashkëpronar apo bashkëtrashëgimtar (*formulae praeiudiciales*), me objekt kthimin e sendit (*actio rei vindicatio*), apo paditë e kthimit të pasurisë trashëgimore (*petitium hereditatis*) njohja e pronësisë është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërimit të paditësit (*shih vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Kjo do të thotë se gjykata në çdo rast është e detyruar fillimisht të hetojë dhe të verifikojë në lidhje me titujt e pronësisë të pretenduara nga palët ndërgjyqëse, të drejtën e pronësisë së pretenduar të paditësit, mënyrën e fitimit të pronësisë, si dhe pretendimet e palës së paditur në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe më pas të pranojë ose jo kërkimet respektive të palëve, eventualisht për lirim dhe dorëzim sendi, sipas pozitës procedurale të tyre në procesin gjyqësor.

63. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji arrin në konkluzionin se, nëse në një konflikt gjyqësor midis dy subjekteve të së drejtës private, që buron nga e drejta e pronësisë, kërkimi për pavlefshmërinë e vendimit të organit përkatës për njohjen pronar dhe kthimin apo kompensimin e pronës, ngrihet në mënyrë incidentale nga pala ndërgjyqëse (si një subjekt i tretë në raport me vendimin), me qëllim kundërshtimin e titullit të pronësisë të pretenduar nga pala kundërshtare, shqyrtimi gjyqësor i këtij kërkimi, si një çështje paragjykimore, ka karakter të ndërvarur dhe të prejardhur me shqyrtimin e kërimit të paditësit, të ndërhyrësit kryesor apo të palës së paditur kundërpaditëse, eventualisht për njohje pronar, bashkëpronar apo bashkë-trashëgimtar apo për kthim sendi apo kthimin e pasurisë trashëgimore. Për rrjedhojë, mos-marrëveshja në rastin konkret nuk e ka burimin nga pretendimet e ish-pronarit për vendimin e organit publik, që ka disponuar në lidhje me të drejtat e tij për njohjen pronar dhe kthimin apo kompensimin e pronës. Kjo çështje tashmë është një mosmarrëveshje midis subjekteve që mohojnë cilësinë e pronarit apo trashëgimtarit të palës kundërshtare apo sillen si pronar dhe trashëgimtar nëpërmjet sundimit ekskluziv dhe përjashtues të pasurisë, padi të cilat bazuar në dispozitat e Kodit Civil vegjohen si mjetet juridike mbrojtëse të pasurisë.

Në këto kushte, këto padi gjenerojnë mosmarrëveshje me natyrë tipike juridiko-civile, që burojnë nga e drejta e pronësisë, midis dy subjekteve të së drejtës private. Këto padi ndjekin regjimin juridik respektiv, të përcaktuar në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile apo ligje të tjera që janë në fuqi dhe si të tilla këto padi janë dhe në kompetencën lëndore të gjykatave të shkallës së parë, që ushtrojnë juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore dhe tokësore në territorin ku ndodhet sendi i paluajtshëm (*forum rei sitae*). Interpretimi i kundërt do të çonte në shkelje të parimit të respektimit të shkallëve të gjyqësorit, i sanksionuar në nenin 135 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me kompetencën e gjykatave për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve.

³⁴ Një qëndrim analog mbahet në Gjykatën e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, pranojnë në vendimin unifikues nr. 9/2 i Regj. Themeltar, nr. 6, datë 24.1.2007.

64. Nga analiza e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludoi në sentencën e dytë të këtij vendimi njësuës dhe vendosi se:

Gjykimi i padisë, kundërpadisë apo padisë së ndërhyrësit kryesor kundër vendimeve të ish-AKKP-së, të ish-KKKP-ve apo ish-ZRAKKP-ve, dhënë në favor të një subjekti, duke pretenduar tërësisht apo pjesërisht për vete sendin e paluajtshëm objekt vendimmarrjeje nga këto organe, kur këto vendime kundërshtohen si tituj pronësie, janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë, ku ndodhet sendi i paluajtshëm.

C. Në lidhje me çështjen e tretë të shtruar për njësim

Cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e padive kundër vendimeve të ATP-së, kur kjo e fundit jep vendim për mbylljen e procedimit pa u shprehur për themelin e kërkimeve: gjykatat e apelit, Gjykata Administrative e Apelit apo gjykatat e shkallës së parë?

65. Fillimisht, Kolegji rithekson se me ligjin nr. 133/2015 u krijua një organ i vetëm, person juridik publik, vendimmarrës, konkretisht ATP-ja, së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e AKKP-së dhe e cila do të trajtojë përfundimisht kërkesat e ish-pronarëve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës.

66. Në nenin 29, të ligjit nr. 133/2015, është parashikuar se:

“Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

Më tej, në nenin 19, të ligjit nr. 133/2015, parashikohet se:

“1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit.

2. ATP-ja publikon vlerësimin në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Pas kalimit të afatit 30-ditor, nëse subjekti i interesuar nuk ka bërë ankim, vlerësimi i vendimit përfundimtar të kompensimit ekzekutohet nga ATP-ja, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”

67. Në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit, është shtruar për diskutim çështja se, në kompetencë së cilës gjykatë do të jetë shqyrtimi i mosmarrëveshjeve midis ish-pronarëve dhe shtetit në rastet kur ATP-ja me vendim jopërfundimtar i jep fund procedimit administrativ pa u shprehur për themelin e kërkesës së ish-pronarit. Kjo për shkak të parashikimit të nenit 15 të ligjit ku parashikohet se:

“Brenda një afati trevjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe sipas përcaktimeve të tij, ATP-ja vlerëson vetëm financiarisht të gjitha vendimet përfundimtare të pavlerësuara që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

2. Nëse ATP-ja nuk përmbush brenda këtij afati 3-vjeçar detyrimin, sipas pikës 1 të këtij neni, subjektit i lind e drejta t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të kërkuar vlerësimin financiar sipas përcaktimeve të këtij ligji...”

67.1 Po ashtu, nga ana tjetër, neni 26 i ligjit nr. 133/2015 ka parashikuar se:

“...Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, drejtori i përgjithshëm i ATP-së shprehbet me vendim brenda afatit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, për: ...

- rrëzimin e kërkesës;

- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimin nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj...”

Sa më sipër, paqartësia në praktikën e gjykatave më të ulëta ka lindur edhe nga interpretimi literal i nenit 26 sipas të cilit ATP-ja mund të vendosë vetëm për themelin e pretendimit të ish-pronarit, përkatësisht duke u shprehur për rrëzimin apo pranimin e kërkesës së ish-pronarit dhe vetëm ndaj këtyre vendimeve mund të bëhet ankim në gjykatat e apelit (civil apo administrativ), sipas

parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 dhe se çdo vendim tjetër i marrë nga ATP-ja do të konsiderohet si akt administrativ i mirëfilltë, për të cilin do të ndiqen rregullat e zakonshme të kundërshtimit të aktit në gjykatat administrative të shkallës së parë.

67.2 Për të konkluduar në lidhje me çështjen e tretë të shtruar për njësim dhe për të zgjidhur të gjitha paqartësitë e interpretimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, Kolegji çmon të marrë në analizë të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis ATP-së dhe subjektit të pretenduar ish-pronar, si dhe të gjitha llojet e vendimmarrjes të këtij organi me qëllim identifikimin në çdo rast të gjykatës kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete.

68. Fillimisht Kolegji vlerëson se parashikimi me këtë ligj, i së drejtës së ankimit, të subjekteve të pretenduara ish-pronare dhe kontrolli gjyqësor ndaj çdo vendimi të ATP-së, në lidhje me njohjen dhe kompensimin e pronës, në bazë dhe për zbatim të neneve 7 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNJ-së ishte kusht i domosdoshëm për vetë vlefshmërinë e ligjit në aspektin material dhe për pajtueshmërinë e tij me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas udhëzimeve dhe orientimeve të GJEDNJ-së në çështjen “*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*”.

69. Kështu, ligji nr. 133/2015 ka parashikuar se çdo lloj vendimmarrjeje e ATP-së, në çdo eventualitet dhe për çdo mënyrë disponimi do t’i nënshtrohet kontrollit gjyqësor për të verifikuar zbatimin e ligjit në mosmarrëveshjet midis shtetit dhe ish-pronarit në çështjet e njohjes dhe kompensimit të pronës. Ky ligj, në mënyrë ezauruese dhe përfundimtare, ka parashikuar për çdo rast forumin gjyqësor kompetent për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të ATP-së. Bazuar në nenet 19 dhe 29, të përmendura më sipër, me ankim në Gjykatën e Apelit do të mundet të kundërshtohen vendimet e ATP-së që lidhen me njohjen e së drejtës së pronësisë, ndërsa paditë ndaj vendimeve të ATP-së që lidhen me kërkesat për kompensimin financiar të pronës, do të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit. Sikurse u trajtua edhe më sipër, parashikimi me ligj i gjykatave të apelit me juridiksion fillestar për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve ishte në përputhje me qëllimin e ligjit për përfundimin e procesit të trajtimit të pronës brenda një afati të arsyeshëm dhe për të shmangur zvarritjet në shkallët e ndryshme të gjyqësorit.

70. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 133/2015, ATP-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuar për trajtimin e pronës, për të cilat nuk është marrë vendim;

b) Shqyrton tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuar dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

c) Shqyrton vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuar, në përputhje me parashikimin e ligjit dhe akteve nënligjore;

d) Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim etj.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, drejtori i përgjithshëm i ATP-së shprehet me vendim brenda afatit ligjor për rrëzimin e kërkesës ose pranimin e saj (neni 26 i ligjit). Po ashtu, ATP-ja shqyrton kërkesat e paraqitura rishtazi dhe të patrajuara më parë. Në çdo rast, drejtori i përgjithshëm i ATP-së ka detyrimin ligjor të shprehet me vendim të arsyetuar, ndaj çdo kërkesë të subjekteve që pretendojnë se janë ish-pronarë, për vendimet (neni 27). Për vendimet e pavlerësuar më parë ATP-ja ka detyrimin t’i vlerësojë financiarisht, sipas kriterëve të ligjit të ri, brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e tij. Në mungesë të veprimit administrativ të ATP-së dhe kur ajo ometon të shprehë vullnetin e saj brenda këtij afati ligjor, të drejtat dhe detyrimet e ATP-së i kalojnë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila do të bëjë përfundimisht vlerësimin financiar sipas parashikimeve të këtij ligji (neni 15). Po ashtu, i njëjti rregull vlen edhe për kërkesat që janë në shqyrtim në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, shqyrtimi i të cilave do të duhet të përfundojë brenda afatit trevjeçar nga hyrja në fuqi e tij, nga ATP-ja. Me kalimin e këtij afati, të drejtat dhe detyrimet e organit administrativ do t’i kalojnë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila do të vendosë përfundimisht në lidhje me kërkesat e ish-pronarit (neni 34).

71. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, dispozitat ligjore të sipërcituara përcaktojnë qartë rastet e

mosmarrëveshjeve mes ATP-së dhe subjekteve të interesuara apo Avokaturës së Shtetit, si edhe gjykatën përkatëse që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes, kur palët i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e tyre:

Së pari, janë vendimet e ATP-së që disponojnë vetëm për vlerësimin financiar të kompensimit të pronës, tashmë të njohur më parë me vendim përfundimtar administrativ të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo AKKP-së, apo vendime gjyqësore që kanë disponuar mbi padi për kundërshtimin e vendimeve të tyre (neni 15, pika 1, në lidhje me nenin 5, pikat 5 dhe 17, si edhe pjesërisht shkronja "b" e pikës 1, të nenit 26, për kërkesat për kompensim financiar të ligjit nr. 133/2015). Pra, janë rastet kur brenda afatit 3-vjeçar, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15, ATP-ja ka nxjerrë vendim lidhur me vlerësimin financiar të kompensimit të pronës. Në të gjitha këto raste, kompetenca lëndore për shqyrtimin e çështjes i përket Gjykatës Administrative të Apelit (neni 19 i ligjit nr. 133/2015);

Së dyti, nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin ligjor për nxjerrjen e vendimit për vlerësimin financiar të kompensimit të pronës brenda afatit 3-vjeçar (pra, për rastet e treguara në paragrafin më sipër), subjekti i interesuar ka të drejtën t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kërkuar vlerësimin financiar, sipas kritereve të ligjit nr. 133/2015 (neni 15, pikat 1 dhe 2);

Së treti, janë rastet e kërkesave të bëra përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 e të patrajtuara nga ish-AKKP, ish-ZRVKKP-të apo ish-KKKP-të (pra, kur nuk ka vendim administrativ përfundimtar, në bazë dhe për zbatim të pikës 17, të nenit 5) apo të kërkesave të bëra brenda afatit të përcaktuar nga ky ligj pranë ATP-së, të cilat kanë për objekt "*trajtimin e pronës*", që do të thotë vetë njohjen e së drejtës së pronësisë shoqëruar me kërkimin për kompensimin fizik ose financiar të saj (pra, jo thjesht vlerësimin financiar të pronës së njohur). Në këto raste, nëse ATP-ja nxjerr vendim për rrëzimin apo pranimin e kërkesës, i cili sipas ligjit duhet të përmbajë arsyetimin dhe disponimin e njëkohshëm jo vetëm për njohjen e së drejtës së pronësisë, por edhe për formën dhe masën e vlerën e kompensimit që duhet të bëhet për subjektin e shpronësuar, kundërshtimi i këtij vendimi nga subjektet e interesuara ose avokatura e shtetit, bëhet drejtpërdrejt në gjykatën e apelit të juridiksionit të zakonshëm, që ka kompetencën territoriale në varësi të rastit konkret, gjykatë e cila e shqyrton çështjen sipas rregullave të KPC-së (nenet 20, 26, 27 dhe 29, të ligjit nr. 133/2015);

Së katërti, nëse brenda afatit 3-vjeçar, ATP-ja nuk përmbush detyrimin ligjor për nxjerrjen e vendimit për trajtimin e kërkesave për trajtimin e pronës (njohje dhe kompensim) me të cilin rrëzon ose e pranon kërkesën (pra, në rastet e treguara në paragrafin më sipër), subjekti i interesuar ka të drejtën t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm, që ka kompetencën territoriale në varësi të rastit konkret, për të kërkuar trajtimin e kërkesës së tyre, njëkohësisht për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kompensimin fizik a financiar, në zbatim dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 133/2015 (neni 34, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 133/2015).

72. Si përfundim, kriteri dallues për përcaktimin e kompetencës lëndore dhe funksionale të gjykatave për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin ndërmjet ATP-së dhe subjektit të interesuar apo avokaturës së shtetit, është vetëm lloji i kërkesës për të cilën është shprehur ose jo ATP-ja dhe lloji i vendimit të dhënë nga ATP-ja për kërkesat e paraqitura. Nëse kërkesa drejtuar ATP-së ka për objekt vetëm vlerësimin financiar të vendimeve (të mëparshme e përfundimtare) për kompensim, kompetenca lëndore i përket gjykatave administrative, funksionalisht Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nëse kërkesa nuk është trajtuar brenda afatit 3-vjeçar dhe Gjykatës Administrative të Apelit nëse ATP-ja është shprehur me vendim për kërkesa të kësaj natyre. Nëse kërkesa drejtuar ATP-së ka për objekt trajtimin e pronës, pra njohjen e së drejtës së pronësisë e njëkohësisht (sipas ligjit) edhe kompensimin fizik a financiar, kompetenca lëndore i përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, funksionalisht Gjykatës së Shkallës së Parë nëse kërkesa nuk është trajtuar brenda afatit 3-vjeçar dhe Gjykatës së Apelit nëse ATP-ja është shprehur me vendim për kërkesa të kësaj natyre.

73. Ligji nr. 133/2015 i ngarkon ATP-së kompetencën për të shqyrtuar dhe për t'u shprehur lidhur

me kërkesat për vlerësim financiar, si edhe për kërkesat për njohje të së drejtës së pronësisë dhe (njëkohësisht) kompensim fizik a financiar të subjekteve të shpronësuara. Por, pasi ka përmbyllur procedurën administrative përkatëse me palën kërkuese dhe bashkërendimin e veprimeve me institucionet, nëse ATP-ja shprehet me vendim. Ligji nr. 133/2015 i përcakton këtij organi administrativ vetëm dy mënyra disponimi, konkretisht vendimmarrjen e rrëzimit të kërkesës ose vendimmarrjen e pranimi të kërkesës së subjektit të shpronësuar. Përfundimisht, ky ligj, në nenin 27, pika 3, parashikon se:

“...të gjitha aplikimet e mbështetura vetëm mbi vërtetimin e faktit juridik, në kuptim të nenit 388, të Kodit të Procedurës Civile, refuzohen nga ATP-ja me vendim.”.

Por edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një shkak ku mbështetet vendimmarrja e ATP-së për rrëzimin të kërkesës së paraqitur për trajtimin e pronës sepse bazohet vetëm në një vendim gjyqësor deklarativ (gracioz) për vërtetimin e faktit juridik.

74. Vendimet e ATP-së, si të çdo organi tjetër shtetëror, pavarësisht se çfarë disponon, nxirren dhe duhet të nxirren pasi të jetë mbyllur procedura administrative e shqyrtimit të kërkesës me hapat, elementet dhe kriteret që i përcakton ligji nr. 133/2015, Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi në tërësi që është i zbatueshëm për çështjen konkrete. Kolegji vlerëson të pabazuar në ligj çdo vendimmarrje të ATP-së që refuzon shqyrtimin në themel të një kërkesë, apo thënë ndryshe vlerësohet i pabazuar në ligj çdo vendimmarrje jopërfundimtar e ATP-së, që mbyll procedimin administrativ dhe nuk e zgjidh çështjen në themel. ATP-ja nuk mundet ta konsiderojë të ezauruar misionin dhe detyrimet e saj duke nxjerrë vendime për mbylljen e procedimit administrativ për shqyrtimin e kërkesës së subjektit të shpronësuar, pa u shprehur për themelin apo meritat e kërkesës. Kolegji vlerëson se, në mbyllje të procedimit administrativ ATP-ja ka detyrimin të disponojë nëse e pranon dhe si e njeh dhe e kompenson të drejtën e pronësisë, apo e rrëzon kërkesën e paraqitur nga subjekti i shpronësuar (neni 15 pika 1, neni 26 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr. 133/2015). Në të dyja rastet vendimi është i shkruar dhe i arsyetuar (neni 25, pika 5, e ligjit nr. 133/2015) dhe, jo vetëm përmbyll procedimin administrativ, por e ka zgjidhur edhe objektin e shqyrtimit në themelin.

75. Në rastin e rrëzimit të kërkesës, motivet përkatëse mund të jenë të natyrës materiale, pra subjektet e shpronësuara dhe përfaqësuesit e tyre janë të legjitimuar, afatet janë respektuar, dokumentacioni është plotësuar etj., por mbi këtë bazë, në kuptimin e ligjit material, e drejta e pronësisë nuk mund të njihet dhe kompensohet, për shkak se nuk kemi të bëjmë me rast shpronësimi të padrejtë, subjekti kërkuar nuk është subjekti i shpronësuar mbi pronësinë që kërkon, sipërfaqja, vendndodhja, natyra, karakteristikat etj. të pronës së shpronësuar pa të drejtë janë të ndryshme nga ajo që pretendon kërkuar, janë rastet e përjashtimit nga trajtimi i pronës (neni 4 i ligjit nr. 133/2015) etj.

76. Por, motivet e rrëzimit të kërkesës mund të jenë edhe të natyrës procedurale, pra mund të lidhen me respektimin ose jo të afateve të paraqitjes së kërkesës, me legjitimitimin e kërkuarve për të kërkuar vlerësimin apo njohjen dhe kompensimin e pronës, legjitimitimin e përfaqësuesve ligjorë të subjekteve të shpronësuar etj., mangësi të cilat edhe pas zhvillimit të procedurës të rregullt administrative e në përmbyllje të tij nuk janë plotësuar nga subjekti kërkuar me dokumentacionin përkatës që ai ka detyrim ta plotësojë sipas ligjit.

77. Në çdo rast, përbën detyrim ligjor dhe ka rëndësi që ATP-ja të tregojë me shkrim, me arsyetim të shtjelluar në mënyrë ezauruese mbi faktin dhe procedurën e ndjekur, se cilat janë motivet që në mbyllje të procedimit përkatës administrativ e kanë sjellë në përfundimin se kërkesa e subjektit duhet të rrëzohet apo të pranohet. Disponimi nga ana e ATP-së vetëm me shprehjen “mbylljen e procedimit administrativ” për shqyrtimin e kërkesës, në kuptimin e termave dhe gjuhës juridike të përdorur është i pasaktë dhe nuk duhet të përdoret prej ATP-së si formë shprehje vullneti sepse disponime të tilla nuk parashikohen në ligjin e posaçëm, i cili i ka përcaktuar se për çfarë dhe si duhet të disponojë ATP-ja. Ndërkohë që në bazë dhe për zbatimin të ligjit, edhe kjo mënyrë e pasaktë të shprehuri në aspektin teknik, duhet të kuptohet si vullnet i qartë i ATP-së për rrëzimin e kërkesës në kuptim të nenit 26, pika

1, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2015. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se edhe këto disponime të pabazuara në ligj e ezaurojnë rrugën administrative të realizimit të të drejtave të ish-pronarëve dhe se ato tashmë mundet që vendimmarrjen administrative të ATP-së ta bëjë objekt kundërshtimi gjyqësor.

78. Pra, pavarësisht nga motivi ku bazohet ATP-ja në vendimin e saj për këto raste, tashmë shqyrtimi në themel i mosmarrëveshjes, që lind nga ai vendim (shkresë përcjellëse, kthim dokumentacioni etj. sipas rastit) i dhënë nga ATP-ja mbi kërkesat e ish-pronarëve i përkasin ekskluzivisht juridiksionit gjyqësor. Kolegji vlerëson se ATP-ja nuk mund të “rishikojë” më vendimin e saj. Kompetenca lëndore e gjykatave të zakonshme apo administrative për shqyrtimin e kundërshtimit të vendimit përcaktohet në varësi të natyrës së asaj që kërkohej (vetëm vlerësim financiar apo njohje e pronësisë plus kompensim). Ndërsa funksionalisht, përderisa ATP-ja ka dhënë një vendim brenda afatit 3-vjeçar, sipas rastit (lëndës së objektit të asaj që kërkohej) është Gjykata e Apelit Administrativ ose Gjykata e Apelit të juridiksionit të zakonshëm që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë në themel çështjen.

79. Kolegji vlerëson se, është në disponimin maksimal të vetë paditësit ndërtimi i kërtimeve të padisë dhe ajo çfarë i kërkon gjykatës, si edhe ndryshimi, shtimi apo pakësimi i shkakut dhe objektit të padisë sipas vetë natyrës së kërtimeve të parashtruara në kërkesën që i ishte drejtuar ATP-së. Gjithsesi, në këndvështrimin dhe misionin ligjor të gjykatave kemi të bëjmë me kundërshtimin e një vendimi, edhe në rastet kur vullneti administrativ është artikuluar në formën e shkresës përcjellëse “*kthim dokumentacioni*”, të dhënë nga ATP-ja. Kështu në kushtet kur ligji i posaçëm: (a) tregon shprehimisht se çfarë lloj vendimesh mund të nxjerrë ATP-ja (rrëzim ose pranim kërkesë, pjesërisht a tërësisht); (b) nuk përcakton kritere penguese për shqyrtimin e kërkesës nga ATP-ja dhe dhënien e një vendimi themeli prej saj; (c) as kritere kushtëzuese për subjektet kërkuese për të kërkuar një vendim themeli nga ATP-ja; (d) as edhe ndonjë rrugë të detyrueshme administrative kundërshtimi të vendimit të ATP-së, atëherë kjo gjendje juridiko-procedurale sjell lindjen e juridiksionit ekskluziv gjyqësor për zgjidhjen në themel të çështjes që i paraqitet për shqyrtim lidhur me mosmarrëveshjen e lindur ndërmjet subjektit kërkuar dhe ATP-së.

80. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në të gjitha rastet kur ka një vendim nga ATP-ja në lidhje me kërkesën e ish-pronarit, pavarësisht mënyrës së disponimit (rrëzim, pranim apo mbyllje e procedimit pa u shprehur për themelin e kërkesës etj.), juridiksioni administrativ në lidhje me këtë kërkesë konsiderohet i ezauruar dhe menjëherë lind e drejta e subjektit të interesuar për t’iu drejtuar juridiksionit gjyqësor, i cili, sipas ligjit nr. 133/2015, do të ushtrohet për herë të parë nga gjykatat e apelit. Sipas rastit kur kërkesa ka pasur si objekt njohjen e pronës dhe kompensim (fizik ose financiar), kompetente do jetë gjykata e apelit në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm dhe kur kërkesa ka pasur si objekt vlerësimin e vendimit të mëparshëm të organit administrativ të kthimit dhe kompensimit të pronës dhe kompensimin financiar, kompetente do të jetë Gjykata e Apelit Administrativ.

81. Kolegji vlerëson se të vetmet raste kur subjektit i lind e drejta t’i drejtohet gjykatave të shkallës së parë (administrative apo të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor) sipas situatave eventuale që mund të lindin në praktikë, të trajtuara më sipër, janë vetëm ato rastet kur nuk ka një vendim të ATP-së mbi të cilin të mund të ushtrohet kontrolli gjyqësor nga gjykatat e apelit me juridiksion fillestar, sepse brenda afatit 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, organi administrativ nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u shprehur në lidhje me kërkesat e ish-pronarit. Vetëm në të tilla raste, të drejtat dhe detyrimet e organit administrativ do t’i kalojnë organeve gjyqësore, konkretisht gjykatave të shkallës së parë (civile dhe administrative) për mosmarrëveshjet të cilat sipas natyrës së tyre në shkallë të dytë, bazuar në nenet 19 dhe 29, të ligjit nr. 133/2015, janë respektivisht në kompetencë të gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit. *Ratio* e këtij parashikimi lidhet me përfundimin e procesit të trajtimit të pronës brenda një afati të arsyeshëm, i cili sipas ligjit është 10 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, në mënyrë që të shmangen zvarritjet dhe në mënyrë të tillë që mosmarrëveshjet midis shtetit dhe ish-pronarit të mos qëndrojnë pafundësisht para juridiksionit administrativ, por të kanalizohen përmes juridiksionit gjyqësor, i cili do të vendosë përfundimisht për

kërkesat e subjekteve të interesuara.

82. Nga analiza e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën e tretë të këtij vendimi njësoj, duke vendosur se:

Gjykata kompetente, për shqyrtimin e padive kundër vendimeve të ATP-së, kur kjo e fundit jep vendim për mbylljen e procedimit pa u shprehur për themelin e kërkesës, në varësi të asaj që kërkohej nga subjekti i interesuar, do të jetë Gjykata e Apelit, në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm, kur kërkohej njohja e pronësisë, sipas nenit 29, të ligjit nr. 133/2015 dhe Gjykata Administrative e Apelit, kur kërkohej vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare të pavlerësuar dhe kompensimi financiar, sipas nenit 19, të ligjit nr. 133/2015.

D. Lidhur me çështjen e katërt të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore

Cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të organeve kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës, sipas ligjeve të mëparshme të shfuqizuara, për kthimin dhe kompensimin e pronës, e cila është regjistruar në gjykatë përpara datës 23.2.2016, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015?

83. Kolegji vlerëson se ligji nr. 133/2015, i ka atribuuar rishtazi dhe në mënyrë të posaçme gjykatave të apelit në Republikën e Shqipërisë (civile dhe administrative) juridiksionin fillestar dhe kompetencën funksionale³⁵ për kontrollin gjyqësor të vendimeve të ATP-së. Nga ana tjetër, nuk ka një dispozitë tranzitore të këtij ligji, ku të përcaktohet se çdo të ndodhë me çështjet në gjykim në kohën e hyrjes në fuqi të tij, për shqyrtimin e vendimeve të marra nga ish-AKKP, ish-ZRVKKP-të apo ish-KKKP-të, të cilat në momentin e paraqitjes së padisë, sipas ligjit të kohës, ishin në kompetencë të gjykatave civile të shkallës së parë, të vendndodhjes së sendit të paluajtshëm (*forum rei sitae*). Ndërkohë, ligji nr. 133/2015 në nenin 3/2, nën titullin “*Fusha e zbatimit*” ka parashikuar se ky ligj i shtrin efektet sa i takon vlerësimit financiar, për:

a) *Egzekutimin e të gjitha vendimeve të cilat nuk janë zbatuar, për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore në vendin tonë;*

b) *Çështjet që janë në shqyrtim në gjykatat e të gjitha niveleve, në Gjykatën e Lartë, si edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa i takon vlerësimit financiar të tyre.”.*

84. Nisur nga ky parashikim i ligjit, çështja juridike që shtrohet për zgjidhje para Kolegjit Civil është: nëse çështjet e regjistruara për gjykim para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, me objekt padie të lëndës që parashikohen në pikën “b”, të nenit 3/2, janë apo jo tashmë në juridiksionin gjyqësor dhe, nëse janë në juridiksionin gjyqësor, cila është gjykata kompetente dhe cili është ligji material i zbatueshëm për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Thelbi i analizës për të konkluduar mbi përgjigjet e këtyre pyetjeve është mënyra se si gjykata individualizon rast pas rasti të drejtën pozitive të zbatueshme mbi një çështje në gjykim, qoftë mbi mënyrën se si vepron ligji procedural në kohë dhe qoftë mbi mënyrën se si vepron ligji material në kohë. Gjykata vlerëson të domosdoshme të ndalet në mënyrën se si përcaktohet ligji i zbatueshëm material dhe procedural në kohë, duke përcaktuar se si normat e detyrueshme të së drejtës individualizohen dhe më tej zbatohen në një mosmarrëveshje objekt gjykimi, në bazë dhe për zbatim të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile apo edhe nenit 17 të ligjit nr. 49/2012 të gjykimit administrativ, duke mbajtur parasysh se ky vendim njësoj po vendos standarde të detyrueshme për t’u zbatuar edhe nga gjykatat civile dhe nga gjykatat administrative që gjykojnë padi që rrjedhin nga ligjet e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave.

85. Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile parashikon ndër të tjera se:

“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj.”.

Në të njëjtën mënyrë formulohet edhe rregullimi kuadër i mënyrës se si gjykata administrative

³⁵ Kompetenca funksionale, është një nënloj i kompetencës lëndore, që përcakton të drejtën e një gjykate të shqyrtojë një kategori të caktuar çështjesh sipas lëndës apo natyrës së tyre, për shkak të funksionit të saj në raport me shkallët e gjyqësorit.

individualizon të drejtën pozitive të detyrueshme. Neni 17 i ligjit nr. 49/2012 parashikon ndër të tjera se:

“2. Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme.”

86. Në këtë mënyrë Kolegji vlerëson se, në çdo rast kur individualizohet, sipas nenit 16 të KPC-së dhe nenit 17 të ligjit nr. 49/2012, e drejta e zbatueshme në një çështje konkrete, duhet të dallohet rast pas rasti marrëdhënia juridike materiale, apo në rastin e konfliktit gjyqësor të ngritur padia në kuptimin material, me marrëdhënien juridike procedurale, apo padia në kuptimin procedural. Kështu për të individualizuar ligjin material të zbatueshëm mbi marrëdhënien juridike materiale të shndërruar në konflikt gjyqësor, si rregull, nuk mund të zbatohet ligji material që është në fuqi në momentin se kur krijohet litispendenca apo kur merr vendimin gjykata, pavarësisht shkallës së gjykimit. Ky konkluzion rrjedh nga parimi kushtetues i sigurisë juridike dhe mungesës së fuqisë prapavepruese të ligjit material, duke qenë se ligji si rregull region vetëm marrëdhëniet juridike që lindin *pro futuro* dhe jo ato që kanë lindur tashmë. Përrjashtim nga ky rregull bën vetëm normat kur ligji parashikon se zbatohen me fuqi prapavepruese. Nga ana tjetër, për rregullimin e marrëdhënies juridike procedurale, apo padisë në kuptimin procedural, si rregull ligji i zbatueshëm do të jetë ligji procedural që është në fuqi në momentin kur investohet gjykata, kur ngrihet padia, apeli apo rekursi. Përrjashtim nga ky rregull bëhet vetëm atëherë kur ligji procedural ka parashikuar ndryshe, duke qenë se gjykatat janë suprimuar.

87. Nga ky konkluzion i përgjithshëm rrjedh se për paditë e paraqitura në gjykatë para datës 23.2.2016 do të zbatohet ligji material që ka qenë në fuqi në momentin e lindjes së të drejtës së padisë në kuptimin material, pasi ky është momenti i cenimit të së drejtës subjektive dhe ligji material që ka qenë në fuqi në këtë moment ka përcaktuar vëllimin cilësor dhe sasior të së drejtës së individit që kërkohet me padi të konfirmohet dhe të realizohet nëpërmjet gjykatës. Kolegji vlerëson se ligji material i zbatueshëm në zgjidhjen e kontestit gjyqësor objekt gjykimi do të jetë ligji që ka qenë në fuqi në momentin kur ka lindur e drejta e padisë në kuptimin material.

88. Konkluzioni i mësipërm është përfundimi sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës. Në rastin konkret neni 3 i ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, ka vendosur rregullime të posaçme, të cilat duhet të mbahen parasysh për të konkluduar se sa përputhet konkluzioni i përgjithshëm i zbatimit të ligjit material në kohë në raport me rastet kur ligjvënësi region ndryshe. Lidhur me fushën e zbatimit të tij, ligji nr. 133/2015 disponon se:

“1. Ky ligj vepron për të gjitha kërkesat, të cilat janë në shqyrtim në AKKP, në ditën e hyrjes në fuqi të tij, si edhe mbi të gjitha ato kërkesa, të cilat do të paraqiten brenda afateve të këtij ligji, sa i takon njohjes së të drejtës së pronës.

2. Gjithashtu, ky ligj i shtrin efektet, sa i takon vlerësimit financiar, për:

a) Ekzekutimin e të gjitha vendimeve, të cilat nuk janë zbatuar, për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore në vendin tonë;

b) Çështjet që janë në shqyrtim në gjykatat e të gjitha niveleve, në Gjykatën e Lartë, si edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa i takon vlerësimit financiar të tyre.”

89. Kjo do të thotë se fusha e zbatimit të ligjit shtrin efektet pjesërisht me fuqi prapavepruese, duke përcaktuar në mënyrë listuese dhe shteruese rastet se kur ligji i ri do të zbatohet edhe për kërkesat, paditë, apelet apo rekursat që janë paraqitur para organeve administrative apo gjykatave para datës 23.2.2016. Fillimisht ligji nr. 133/2015 e shtrin efektin prapaveprues të rregullimit për të gjitha kërkesat që në datë 23.2.2016 janë në shqyrtim në AKKP, e cila shndërrohet në ATP. Kjo do të thotë se ATP-ja nga data 23.2.2016 do të shqyrtojë dhe disponojë të gjitha kërkesat e trashëguara nga AKP-ja sipas regjimit juridik të ligjit nr. 133/2015.

90. Më tej ligji nr. 133/2016 parashikon se vlerësimi financiar sipas formulës së parashikuar nga ky ligj do të regjojë edhe ekzekutimin e të gjitha vendimeve të njohjes së të drejtës së kompensimit të pronës së ish-pronarëve, të dhëna nga organet administrative dhe/ose gjyqësore ndër vite. Duke pasur parasysh problematikën e krijuar nga vendimet e paekzekutueshme dhe konkluzionet e GJEDNJ-së të analizuara

dhe sqaruara më lart, Kolegji vlerëson se shtrirja e fuqisë prapavepruese e ligjit nr. 133/2015 në këto raste është e justifikuar, pasi vendimet e njohjes së drejtës së kompensimit, që nuk përcaktojnë dhe nuk individualizojnë një vlerë konkrete, nuk mundet të konsiderohen si tituj dhe nuk futen në mbrojtjen e nenit 1, të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Kjo justifikon ndërhyrjen legjislative të ligjvënësit edhe me fuqi prapavepruese, pasi qëllimi është realizimi i së drejtës subjektive të individëve dhe përfundimi i procesit të trajtimit të pronës.

91. Më tej, ligji nr. 133/2015 parashikon se efektet rregulluese prapavepruese të tij do të shtrihen edhe për të gjitha çështjet që janë në shqyrtim në gjykatat e të gjitha niveleve, në Gjykatën e Lartë, si edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa i takon vlerësimit financiar të tyre. Nën të njëjtën logjikë ligji nr. 133/2015 e shtrin fuqinë prapavepruese të rregullimit edhe mbi kërkesat, paditë, apelet apo rekursat e paraqitura para datës 23.2.2016, me kushtin që objekti i tyre të jetë vlerësimi financiar i pronës. Kjo do të thotë se ligjvënësi është kujdesur që t'i japë fuqi prapavepruese ligjit material vetëm për individualizimin, realizimin dhe konfirmimin e të drejtave subjektive të individit që nuk kanë gjetur konkretizim deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, me qëllim dhënien fund të procesit. Kjo do të thotë se Kuvendi nuk i ka lejuar ligjit që të rregullojë me fuqi prapavepruese edhe kërkesat, paditë, apelet apo rekursat që janë ngritur para datës 23.2.2016, dhe që rrjedhin nga ligjet e mëparshme të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës, dhe që në objektin e tyre nuk kërkojnë vlerësimin financiar dhe kompensimin monetar të pronës. Për të gjitha këto çështje në gjykim, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, gjykatat do të zgjidhin mosmarrëveshjet mbi bazën e ligjit material të kohës kur ka lindur e drejta e padisë në kuptimin material.

92. Sipas dallimit të bërë më lart, mbi lindjen e marrëdhënies juridike materiale dhe procedurale, mbetet që Kolegji të konkludojë mbi zbatimin e ligjit procedural që rregullon kompetencën apo juridiksionin e gjykatës së caktuar me ligj, për të gjitha çështjet gjyqësore në të cilat paditë dhe rekursat janë paraqitur para datës 23.6.2016. Për të konkluduar mbi këtë çështje të shtruar për njësim, fillimisht, Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kompetenca lëndore apo funksionale e gjykatës është drejta e saj për shqyrtimin e një kategorie të caktuar mosmarrëveshjesh, sipas lëndës dhe natyrës së tyre. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se ligji procedural e përdor kompetencën si mjet për të disiplinuar ushtrimin e rregullt të juridiksionit gjyqësor dhe se nëpërmjet saj përcaktohet dhe individualizohet rast pas rasti, pasi fakti objekt gjykimi ndodh, se kush do të jetë gjykata e caktuar me ligj që do të gjykojë mosmarrëveshjen.

93. Në aspektin kushtetues, kompetenca lëndore apo funksionale e gjykatës është shumë e rëndësishme, si element që garanton procesin e rregullt ligjor, është kusht për vlefshmërinë e procesit gjyqësor dhe të akteve të realizuara gjatë tij në kuptimin që një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale. Ky konkluzion e ka bazën te postulati: *“Nuk mund të ketë bindje ndaj një gjyqtari jokompetent”*. Në jurisprudencën e GJK-së, koncepti juridik i kompetencës është trajtuar nën standardin e gjykatës së caktuar me ligj, si pjesë përbërëse e nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 23/2009, nr.7/2009 dhe nr. 31/2005 dhe nr.16/2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

94. Për të sqaruar se çfarë do të kuptohet me standardin konventor dhe kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj, Kolegji sjell në vëmendje nenin 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka parashikuar se:

“1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj...3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.”

Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, pranohet se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar rezervën ligjore, duke i deleguar ligjvënësit të drejtën për t'i atribuar gjykatave kompetencën dhe juridiksionin për çështje të ndryshme në varësi të natyrës së tyre, mjafton të respektohet detyrimi i paderogueshëm se nuk mund të krijohen gjykata të jashtëzakonshme. Pra, Kuvendi mund të krijojë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, sipas së drejtës së përgjithshme të kujtudo për të kërkuar mbrojtjen e të

drejtave subjektive, lirive dhe interesave të tij para një tribunali gjyqësor, po ashtu mund të krijojë edhe gjykata të specializuara në fusha të posaçme, por nuk mund të krijojë gjykata të jashtëzakonshme të cilat i paraprijnë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Vetëm pika 2 parashikon normë dhe rezervë kushtetuese për krijimin e gjykatës së posaçme penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por një teknikë e tillë legjislative në hartimin e normave kushtetuese është më shumë përjashtim nga rregulli se sa një rregull.

95. Në çdo rast është ligji ai që i atribuon gjykatave juridiksionin dhe kompetencën për shqyrtimin e çështjeve të caktuara, duke individualizuar kriteret *in abstracto* se si gjykatat marrin juridiksion apo kompetencë për një çështje konkrete. Pra, kur flitet për caktimin e gjykatës së caktuar me ligj, ky standard implikon disa dimensione:

Së pari, gjykata të jetë konstituuar nga ligji, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore/funksionale dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve;

Së dyti, ligji të ketë caktuar mënyrën dhe momentin se si gjykata merr juridiksion dhe kompetencë.

Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete.³⁶ E anasjella nuk mund të ndodhë, që çështja konkrete t'i paraprijë ligjit që i atribuon gjykatës kompetencën dhe juridiksionin për shqyrtimin e saj, pasi në këtë rast do të ishim në fushën e veprimit të ndalimit kushtetues se nuk mund të ketë gjykata të jashtëzakonshme. Kjo garanton gjykimin e kujtdo shtetasi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

96. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë elaboruar disa kriterë themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Megjithëse në të drejtën pozitive procedurale civile në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite *parimi i gjyqtarit natyral të çështjes*, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe sidomos jurisprudenca e GJK-së ka pranuar se rendi juridik shqiptar një ndër elementet kryesore të gjykatës së caktuar me ligj ka standardin e gjyqtarit natyral³⁷, standard i cili është nga ana tjetër edhe e drejtë themelore e individit. *Ratio* e krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure autoritative shtetërore është te nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie i paanshëm përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm. Ky është një ndër premtimet kushtetuese që Republika e Shqipërisë me hyrjen në fuqi të Kushtetutës i ka bërë çdo subjekti të së drejtës.

97. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pajuridiksion apo jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe.

98. Nga kjo analizë konkludohet se ndryshimi i rregullave procedurale mbi përcaktimin e juridiksionit, kompetencës apo formësimit të gjyqtarit natyral të çështjes është përjashtim nga rregulli dhe jo rregull. Kjo do të thotë se nëse Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji nuk ka rregullim tranzitor eksplicit për ndryshimin e juridiksionit, kompetencës apo gjyqtarit natyral për çështjet gjyqësore që gjen në gjykim, atëherë rregulli i përgjithshëm parim kushtetues dhe konventor i gjyqtarit natyral dhe vazhdimësisë së juridiksionit dhe kompetencës (*perpetuatio jurisdictionis et perpetuatio*

³⁶ Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³⁷ Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

fori) do të zbatohet natyrshëm në të gjitha këto gjykime.

99. Në këtë kuptim doktrinat shkencore të së drejtës procedurale civile evropiane kanë krijuar institutin *perpetuatio iurisdictionis* dhe *perpetuatio fori*, për të konceptuar dhe regjuar juridikisht çështjet primare dhe fillestare se si konstituohet juridiksioni, kompetenca dhe gjyqtari natyral dhe se si ruhet permanenca dhe vazhdimësia e pandërprerë e kësaj figure gjyqësore garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të çdo subjekti të së drejtës, çështje të cilat nga ana tjetër janë edhe prezumimet procedurale kryesore dhe absolute të vlefshmërisë së procesit gjyqësor. Kjo do të thotë se, në momentin kur çështja regjistrohet në gjykatë, konkretisht për procesin civil dhe administrativ kur padia paraqitet në gjykatë sipas nenit 153 të Kodit të Procedurës Civile, atëherë individualizohet edhe ligji që rregullon gjykatën kompetente dhe mënyrën e formimit të trupit gjykues. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për rrjedhojë vlerëson se, çdo ndryshim i mëvonshëm i faktit dhe i ligjit është irrelevant për të konkluduar mbi këto çështje procedurale. Pikërisht nëpërmjet kësaj mënyre zbatohet neni 42 dhe neni 135 i Kushtetutës, duke individualizuar që në momentin kur regjistrohet padia, gjykatën dhe gjyqtarin natyral të çështjes.

100. Krahas garancisë për gjykimin e kujtdo nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Kolegji vlerëson se parimi *perpetuatio iurisdictionis et fori* e ka burimin te parimi i sigurisë juridike, si parim themelor i shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet dhe çështjet e rregulluara më parë. Ajo ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.³⁸ Nevoja për qëndrueshmëri dhe siguri në marrëdhëniet juridike, në radhë të parë, kërkon pandryshueshmërinë e akteve juridike që formulojnë rregullat e përgjithshme dhe abstrakte. Parimi i sigurisë juridike nënkupton se ligji rregullon marrëdhëniet juridike të së ardhmes dhe nuk ka efekt prapaveprues, për marrëdhëniet e lindura para hyrjes në fuqi të tij.

101. Nën këtë frymë dhe në bazë të parimit *perpetuatio fori* dhe *perpetuatio iurisdictionis* u frymëzuan edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile, konkretisht mendimet e ligjit nr. 38/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 5.11.2017. Më konkretisht në nenin 36/5 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar, parashikohet se:

“Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit.”.

Po ashtu, neni 41, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Kompetenca përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit ose të ligjit.”.

Nga ana tjetër, në ligjin nr. 49/2012 për gjykimin administrativ, të ndryshuar, nuk ka dispozita që e njohin në mënyrë eksplicite parimin kushtetues të *perpetuatio iurisdictionis* apo *perpetuatio fori*, por neni 1 pika 2 e tij thërret zbatimin në mënyrë komplementare të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile për sa kohë emeton nga rregullimi i një çështje. Kjo do të thotë se nenet 36/5 dhe 42/2 të Kodit të Procedurës Civile janë parashikime dhe rregullime normative edhe të gjykimit administrativ. Po ashtu, pika 1 e nenit 22 të Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

“1. Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.”.

Më tej, neni 23 i këtij ligji, sanksionon se:

“1. Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.”.

2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin

³⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 9, datë 26.2.2007.

procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.”.

102. Nga kjo analizë krahasuese e legjislacionit procedural, Kolegji konkludon mbi ekzistencën e një parimi procedural *jus cogens* mbi mënyrën se si individualizohet një autoritet shtetëror që ka juridiksion, kompetencë dhe se si formësohet nga ligji në kohë trupa gjykuese natyrale e çështjes për të ushtruar këtë pushtet të njohur nga ligji. Kjo do të thotë se ligji që përcakton juridiksionin, kompetencën dhe mënyrën se si individualizohet gjyqtari natyral i çështjes në procesin civil është ligji që është në fuqi kur paraqitet padia në gjykatë apo kur lind marrëdhënia juridike-procedurale civile (*gjendja e litispendencës*). Çdo ndryshim i mëtejshëm i faktit apo i ligjit është jorelevant, për rrjedhojë nuk mund të spostojë apo të ndryshojë gjyqtarin natyral të caktuar më parë për shqyrtimin e çështjes.

103. Nisur nga analiza dhe konkluzioni që u bë më lart, duke pasur parasysh parimin e *perpetuatio jurisdictionis et fori*, Kolegji vlerëson të nevojshme të theksojë se gjykata është e detyruar, që në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, të marrë në shqyrtim edhe kryesisht (*suo moto*) çështjen nëse ka juridiksion apo kompetencë, qoftë edhe pa prapësimin procedural të palëve, me përjashtim të kompetencës që ligji e njeh si prapsim në kuptimin e ngushtë dhe e drejtë procedurale për ta kontestuar apo reklamuar para gjykatës vetëm nga palët. Megjithatë, ky rregull, që ka dashur të garantojë në çdo moment vlefshmërinë e procesit gjyqësor, nuk do të thotë se gjykata në këto rast shqyrton juridiksionin dhe kompetencën në raport me ndryshimet e mëvonshme që ka pësuar “fakti” apo “ligji”. Përkundrazi, gjykata e çdo shkalle në këto raste shqyrton, nëse ***në situatën faktike dhe juridike kur është ngritur padia***, ajo ka pasur juridiksion apo kompetencë dhe në bazë të këtij konkluzioni disponon sipas çdo eventualiteti me vendim jopërfundimtar apo me vendim të ndërmjetëm.³⁹ Kështu, në çdo rast hulumtimi dhe procesi vlerësues që i paraprin vendimmarrjes së ndërmjetme apo jopërfundimtare mbi juridiksionin apo kompetencën është një shqyrtim retrospektiv dhe jo i përditësuar, ku optika vlerësuese e gjyqtarit hidhet te momenti ku padia civile apo administrative është paraqitur dhe gjykimi ka nisur.

104. Kolegji vlerëson se këto parime të përbotshme *ius cogens* do të duhet t’i shërbejnë gjykatave, në zbatim të nenit 1/2 të KPC-së, sa herë nuk ka ligj apo sa herë nuk ka një dispozitë tranzitore të ligjit që formon rishtazi gjykata të specializuara apo gjykata të posaçme, që të përcaktojë se çdo të ndodhë me çështjet në gjykim, për shqyrtimin e të cilave kompetenca apo juridiksioni i ishte përcaktuar sipas ligjit të kohës kur ishte paraqitur padia në gjykatë. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit garanton gjykimin e kujtudo nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj dhe mbi të gjitha garanton gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

105. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludon se, pavarësisht se ligji nr. 133/2015, i cili i atribuon në mënyrë të posaçme gjykatave të apelit (civil apo administrativ) juridiksion fillestar për shqyrtimin e vendimeve të ATP-së, nuk ka një dispozitë tranzitore ku të përcaktohet në mënyrë eksplicite se çdo të ndodhë me çështjet në gjykim në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke iu referuar parimeve të përgjithshme të analizuara më sipër, kompetenca dhe juridiksioni për shqyrtimin e këtyre çështjeve ishte përcaktuar me ligjin e kohës kur është paraqitur padia në gjykatë. Në këtë mënyrë, për shqyrtimin e vendimeve të ish-AKKP-së, të ish-KKKP-ve apo të ish-ZRVKKP-ve, të marra para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, kompetenca e gjykatës është përcaktuar nga ligji, që ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë dhe praktika gjyqësore respektive e unifikuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudenca e GJK, duke ndarë momentin se kur është marrë vendimi që ka konstituuar ose jo marrëdhënien juridike materiale të pronësisë, nga momenti se kur konstituohet marrëdhënia juridike-procedurale, e cila lind me paraqitjen e padisë në gjykatë.

106. Në vijim të këtij arsyetimi Kolegji vlerëson se, neni 3 i ligjit nr. 133/2015, duke qenë se sanksionon parimin e prapaveprueshmërisë së ligjit, si përjashtim nga rregulli, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë *stricto sensu* dhe po ashtu, nga të gjitha mënyrat e interpretimit, duhet aplikuar ai që është në pajtim me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të sigurisë juridike dhe me parimin e *perpetuatio iurisdictionis et*

³⁹ Shiko nenin 59 dhe 61 të Kodit të Procedurës Civile.

fori. Kjo do të thotë se neni 3 i ligjit nr. 133/2015 duhet të interpretohet në përputhje me frymën e ligjit dhe *ratio*-s së tij, duke pasur parasysh se pse u miratua ligji dhe duke sjellë në vëmendje analizën e bërë në pjesën e parë të këtij vendimi njëses, në lidhje me qëllimin, fushën e veprimit dhe objektin e tij.

107. Nga analiza e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludoi në sentencën e katërt të këtij vendimi njëses dhe vendosi se:

Gjykimi i padive kundër vendimeve të ish-AKKP-së, të ish-KKKP-ve, apo ish-ZRAKKP-ve, të ngritura dhe të regjistruara në gjykatë, nga subjektet ish-pronare apo nga trashëgimtarët e tyre, para datës 23.2.2016, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 133/2015, do të vazhdojë dhe do të përfundojë nga gjykatat civile të shkallës së parë në territorin e të cilave ndodhet sendi i paluajtshëm, objekt konflikti gjyqësor, kompetenca dhe juridiksioni i të cilave, sipas parimeve *perpetuatio iurisdictionis* dhe *perpetuatio fori*, ishte përcaktuar sipas ligjit të kohës në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë.

VI. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

108. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, paditësi ka pretenduar pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme, në bazë të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, duke pretenduar se vendimi i Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Korçë, nr. 1007, datë 18.6.2009, i cili nuk e ka kthyer si të lirë sipërfaqen prej 2450 m² (s1) dhe 357 m² është i paligjshëm. Në këto kushte paditësi ka pretenduar se kjo sipërfaqe posedohet në mënyrë të paligjshme nga pala e paditur, konkretisht z. Kristo Çipi dhe z. Gjela Çipi dhe, si rrjedhojë, ka kërkuar ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe kthimin si të lirë të sipërfaqes objekt mosmarrëveshjeje. Nga ana tjetër, palët e paditura kanë kërkuar me kundërpadi të njihen pronar mbi këtë pasuri.

109. Kolegji vlerëson se në rastin konkret mosmarrëveshja është themeluar mbi bazën e pretendimeve të dy subjekteve të së drejtës private për të drejtat e pronësisë mbi një send të paluajtshëm dhe ku pretendimi për paligjshmërinë e vendimit i organit administrativ kompetent për kthimin dhe kompensimin e pronës, si titull pronësie është pjesë e shkakut të padisë. Duke u mbështetur në konkluzionin e dytë njëses të këtij vendimi, mosmarrëveshje të tilla janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë në territorin e të cilave ndodhet sendi i paluajtshëm.

110. Sa më sipër, Kolegji vlerëson e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka kualifikuar drejtë natyrën e mosmarrëveshjes për efekt të identifikimit të kompetencës lëndore/funksionale. Si rrjedhojë, vendimi nr. s’ka, datë 25.5.2017, me të cilin është shpallur moskompetenca për shqyrtimin e padisë, duke i dërguar aktet Gjykatës së Apelit Korçë është i pabazuar në ligj. Si i tillë, ky vendim duhet të priset dhe çështja të kthehet për vazhdimin e gjykimit pranë asaj gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 141/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 62 të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. s’ka, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit;
2. Ky vendim është njëses i praktikës gjyqësore;
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare.

Kryesues: Artan Broci

Anëtarë: Shkëlzen Selimi, Medi Bici